



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.2(439)

SHKURT 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

HISTORIA



81 VJETORI
- BRIGADA E
PESTË, HISTORI
SUKSESHE TË
NJËPASNJËSHME


Gjeneral Rahman Parllaku

Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit

FAQE 2

IN MEMORIAM

**TAHIR KADAREJA, NJERIU DHE
USHTARAKU ME PËRMASAT E
NJË PERSONALITETI**



Nga Vangjel Kasapi

FAQE 5

LAMTUMIRA



**MINIR DUSHI,
PERSONALITET
I SHQUAR
I SHKENCËS DHE
ARSIMIT
NË KOSOVË**

Nga Bashkim Hisari

FAQE 4

Salla e Konferencave Ndërkombëtare të FPU merr emrin e kreut shqiptar më të suksesshëm

ALFRED MOISIU – NJË JETË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE PAQES

TË RRISIM KUJDESIN PËR NDALIMIN E SHPËRBËRJES SË FAMILJES SHQIPTARE

Nëntëdhjetëepesë vite punë dhe përpjekje për të bërë më të mirën për shoqërinë, familjen, vendin nuk janë pak. Pasi shprehu kënaqësi dhe nder të për këtë akademi jubilarë që organizoi në 95 vjetorin e lindjes së tij Federata Shqiptare e Paqes Universale, e mbështetur edhe nga qendra, (gjë për të cilën falenderoi përzemërsisht drejtuesit e saj dhe në mënyrë të veçantë përfaqësuesit që ndodheshin në këtë sallë, e në veçanti Presidentin Vujanoviç, zotin Wilson Ahmeti dhe Dr. Song, Sekretarin e Përgjithshëm të FPU Gani Rroshi)...

FAQE 2



ALFRED MOISIU
Një jetë në shërbim të kombit dhe paqes

Si bashkëthemelues dhe bashkëdrejtues, para tri dekadave, me Dr. Ymer Dishnicën, gjeneral Parllakun, Josif Zegalin, Nexhip Vinçanin, Liri Belishovën, Edip Ohrin, Hamit Keçin, Kiço Ngjelën, Sadik Bekteshin, Zenepe Ashikun, Vera Pojanin etj, Kuvendi i 9 i OBVLP i datës 26 korrik 2024, e zjodhi Alfred Moisiun President Nderi të kësaj organizate

FAQE 16

OVLANÇ TË KOSOVËS DO TA KUJTOJË ME KRENARI XHA FER HAXHIJAKUPIN

FAQE 4

AKTUALITET

FARSH, vlerë e shtuar e Aleancës

Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare



FAQE 7

HISTORIA

**81 VJET MË PARË –
OPERACIONI I MADH
ARMIK I DIMRIT 1943-1944**
Sipas kujtimeve të ish nënkryetarit e kryetarit të OBVLP,
kolonel Myfit GUXHOLLI

FAQE 6

80 VJET MË PARË

**MARSHIMI HEROIK
I TRE BATALIONEVE
TË BRIGADËS SË PARË
SULMUESE**

FAQE 10

HOMAZHE

- UKË CENA, USHTARAKU DHE JURISTI SHEMA BULLOR QË S'DO HARROHET KURRË
- LAMTUMIRË DASHNOR SYRJA ZEQRILLARI
- SEFER KOÇI - NJË VETERAN NË PARAJSË

Faik Xhani, Sakip Sula

FAQE 12

PORTRET

**VETERAN I ARSIMIT HAZIR
SELISHTA, STUDIUES I
KULTURËS POPULLORE**

NGA MEVLUD BUCI

FAQE 13

SUPLEMENTI FJALA

**“SHTËPIA E VERDHË”, PROTESTA E
MEREMES NDAJ CARLA DEL PONTE**
...dhe një tufë ferrash në varrin e Dick Marty, nga
Destani, i Zoti i Shtëpsë...

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

FAQE 8

**DHIMBJE PËR HUMBJEN E MIKUT
TË RRALLË AKADEMIKUT KOPI
KYÇYKU**

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 2

MIRË... PO PRAPA DIELLIT

Tregim nga Sulejman MATO

**FESTAT E FUND VITIT BËNË
BASHKË SHKRIMTARËT DHE
VETERANËT**

Nga Nuri Bufi

FAQE 2

HISTORIA

Luftëtarët e saj përbënin një bashkim monolit që e thyenin e shpartallonin armikun kudo

81 vjetori - Brigada e Pestë, histori suksesesh të njëpasnjëshme

• *Mbas luftimeve në Kosovë, Brigada e Pestë S bashkë me atë të Tretë dhe 25- të u inkuadruan në Divizionin e V-të që pata nderin ta komandoj në luftimet në tokat e ish - Jugosllavisë. Sa u gëzova që pas një periudhe 7 mujore do isha bashkë me shokët e mi e do të ndanim së bashku vuajtjet dhe sakrificat që kërkon lufta; hidhërimet kur të vriten shokët, po dhe gëzimet që të jep fitorja...*

Gjeneral Rrahman Parllaku

Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit

Luftëtarët e Brigadës, si gjithë luftëtarët antifashistë e përkujtuan këtë ditë me krismat e armëve kundër okupatorëve nazistë-gjermanë që kishin zëvendësuar fashistët italianë. Brigada e filloi jetën si njësi e organizuar më 28 Nëntor '43, e komanduar nga Heroi i Popullit Abaz Shehu, i cili ishte një nga dëshmorët e parë të saj.

Që në krijimin e saj, fillimisht me tre batalione, Brigada e Pestë Sulmuese u përfshi menjëherë në luftë kundër zaptuesit nazist gjerman e bashkëpunëtorëve të tij, duke përbërë një operacion që ndërmoren okupatorët në krahinat e Vlorës, me qëllim që të godisnin forcat e grumbulluara për krijimin e Brigadës, por ato në krijim e sipër e thyen operacionin armik. U shtuan radhët me luftëtarë të rinj dhe më 20 janar 1944 Brigada u rrjeshtua në Bramish të Tërbaçit për përrurimin e saj.

Në përbërje kishte pesë batalione me afro 1000 luftëtarë, me komandant Shefqet Peçin e komisar Hysni Kapon; e organizuar dhe e gatshme për të përbërë beteja të vështira, por edhe për të korrur fitore të lavdishme. Trimat që e përbënin atë fillimisht, ishin kryesisht nga qarku i Vlorës, por më vonë nga lëvizja nga qarku i Vlorës, në të u përfshinë me qindra e qindra luftëtarë nga Leskoviku e deri nga Kukësi e Kosova.

Në përbërjen e saj pati luftëtarë, dëshmorë e heronj nga e gjithë Shqipëria, madje nga i gjithë kombi. Luftëtarët e saj përbënin një bashkim monolit që e thyenin e shpartallonin armikun kudo. Në ditën e inagurimit, ende pa u prishur rrjeshtimi i saj, ko-



• *Është detyra jonë që traditat luftarake të Brigadës së Pestë heroike t'ua transmetojmë brezave të ardhshëm, se ato bëjnë pjesë në thesarin brilant të traditave shekullore të të parëve tanë. Kjo edhe për faktin se moshë mesatare e efektivit të Brigadës së Pestë ka qenë lule e rinisë nga 15-22 vjeç. Ata luftuan e ranë për një ideal të lartë, për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, për lirinë e popullit të tyre, për një Shqipëri demokratike, me ato ideale që përcaktoi konferenca e Pezës. Po fatkeqësisht në luftëtarët jemi zhgënjyer, se diktatura enveriane nuk u qëndroi besnike idealave për të cilat luftuam e për të cilat ranë shokët tanë. Sepse ajo e katandisi vendin tonë në më të varfërin e Europës. Detyra jonë sot është të mbështesim proceset demokratike, konsolidimin e shtetit ligjor e forcimin e rendit juridik që lidhen drejtpërsëdrejti me integrimin e Shqipërisë në Europë. Për ne mbi gjithçka janë interesat e Atdheut e të Kombit*

mandantët e batalioneve morën detyrat luftarake për të përbërë ofensivën e madhe që ndërmoren gjermanët në dimrin e 1943-1944 kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare për asgjësimin e saj.

Urdhëri i luftimeve që lëshoi Shtabi i Brigadës i vendoste forcat në këtë mënyrë: batalionet e dytë e të katërt mbeteshin për mbrojtjen e krahinave të Vlorës, batalioni i tretë në mbrojtje të Bregdetit, kurse

batalionet e parë e të pestë në mbrojtje të Kurveleshit të Sipërm nga Kaparieli deri në Salari, ku vepronte bashkë me ta edhe batalioni "Perlat Rexhepi". Luftimet u zhvilluan në kushte tepër të vështira të dimrit të ashpër përballë një armiku shumë superior në forca e sidomos në teknikë luftarake. Krahinat ku vepronin forcat e brigadës ishin të djegura e të shkatërruara nga armiku. Mungonte edhe buka për vetë popullin, mbasi kur kishte ai kishim edhe ne. Por partizanët i përbërë këto vështirësi dhe i kaluan dhimbjet e humbjeve të rënda që kishin pësuar. Ata u riorganizuan shpejt dhe me mesymje i shpartalluan forcat armike, çliruan krahinat e Kurveleshit, Kudhësit, Treblovës, Mesaplikut etj. Pas çlirimit të këtyre krahinave, brigada jo

vetëm i shtoi radhët e saj me partizanë të rinj, por edhe u organizua e u kompatësua efektiviteti i saj. Forcat e brigadës për asnjë ditë nuk i rreshtën luftimet duke mbrojtur zonat e çliruara e goditur armikun kudo deri edhe brenda në qytetin e Vlorës.

Në një nga këto luftime ra heroikisht zëvendës komandanti i brigadës, Heroi i Popullit, Dervish Hekali. Luftimet, sakrificat dhe heroizmat e partizanëve të Brigadës së Pestë do i kujtojë gjithmonë populli i qarkut të Vlorës, jo vetëm për faktin se në radhët e saj kishte djalin ose vajzën pjesa më e madhe familjeve vlonjate, por edhe pse i kishte strehuar e ushqyer vet duke ndarë me ta kafshatën e bukës së fëmijëve; u kishte mjekuar plagët, por edhe kishte qenë dëshmitar e pjesëmarrës në shumë luftime përkrah tyre; se me dhënien e alarmit të rrezikut ngriheshin burra e gra të fshatit e luftonin përkrah partizanëve e në ndihmë të tyre. Kush nga ne nuk e ka parë e ndier këtë solidaritet e përkrahje të popullit heroik të Vlorës dhe që nuk mund të harrojmë kurrë.

Në fillim të prillit 1944, brigada mori urdhër për të kaluar në zonën e Gjirokastrës dhe për t'u vënë në mbrojtje të zhvillimit të punimeve të Kongresit të Përmetit, në sektorin e Tre Urave deri në Barmash të Kolonjës. Pas Kongresit të Përmetit, e inkuadruar në Divizionin e Parë, mori urdhër për të kaluar në Shqipërinë e Mesme e të Veriut. Gjatë rrugës për kalimin në Veri, Brigada mori pjesë në luftimet për thyerjen e operacionit armik të Qershorit. Luftime të ashpra deri trup me trup zhvilluan partizanët e kësaj brigade me forcat naziste në Qafën e Gjarpërit, Shëmbërdhenjë, Qafë Dardhë etj, duke i shkatëruar armikut qindra të vrarë. Me kalimin në Shqipërinë e Veriut zhvilloi luftime të ashpra për çlirimin e Matit e

Dibrës kundër forcave naziste e bashkëpunëtorëve të tyre. Veçanërisht të ashpra qenë luftimet në krahinën e Kurdarisë e Macukullit në rrethin e Matit, luftimet për çlirimin e Dibrës e Peshkopisë, në Sinjë e Fushë Alie kundër forcave naziste e mercenare të kriminelit Halil Alia, xhandarëve e bashibozukëve me të cilët mjaftë nga partizanët i kishin provuar armët në luftime me ta në malin e Tragjasit, Gumenicës e në Gjorm në janar 1943.

Në të gjitha luftimet e zhvilluara partizanët e brigadës treguan vendosmëri e trimëri të rrallë në luftime dhe për përbërë situatave shumë të vështira nga Vlora deri në Kukës, që ishin edhe luftimet e fundit brenda kufijve shtetërorë e që përfunduan me çlirimin e krahinës së Lumës dhe mbajtjen nën kontroll të rrugës Kukës-Prizren.

Brigada zhvilloi luftime të ashpra me forcat naziste dhe xhnadramërinë e Xhafer Devës, mercenarët që kishin kryer masakrën e 4 shkurtit në Tiranë e krime të tjera, për çlirimin e Gjakovës dhe Prizrenit e krahinave të tjera të Kosovës. Veçanërisht të ashpra qenë luftimet për çlirimin e Gjakovës.

Me çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit e Kosovës, forcat e Brigadës së Pestë bashkë me ato të Brigadës së Tretë dhanë një kontribut të rëndësishëm, jo vetëm për çlirimin e popullit të Kosovës, por dhe në përfshirjen

(Vijon në faqen 10)



NDERIMI

Salla e Konferencave Ndërkombëtare të FPU merr emrin e kreut shqiptar më të suksesshëm

ALFRED MOISIU – NJË JETË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE PAQES

- *Rreth 150 personalitete të nderuara, Ambasadorë për Paqe, drejtues të Federatës së Paqes Universale në nivel evropian dhe ndërkombëtar morën pjesë në një veprimtari të veçantë në vlerësim të kontributit të jashtëzakonshëm të Presidentit Moisiu për rritjen dhe zhvillimin e Federatës së Paqes Universale në Shqipëri dhe Ballkan. Surpriza e veprimtarisë ishte ceremonia e vendosjes së emrit “Alfred Moisiu” sallës modern të konferencave të Ambasadës së Paqes*

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Mkarierën e tij të shkëlqyer si pjesëmarrës aktiv në LANÇ, si ushtarak dhe drejtues i talentuar i Ushtrisë Shqiptare dhe mbi të gjitha si Presidenti më i suksesshëm shqiptar i këtij çerekshkulli, Alfred Moisiu, padyshim zë vend të veçantë në panteonin e vlerave të kombit shqiptar.

Në 95-vjetorin e ditëlindjes, personalitete shqiptare dhe ndërkombëtare kanë evidentuar më së miri përkushtimin e tij ndaj lirisë së atdheut (si emblemë e qëndresës ndaj pushtuesit nazifashist), përkushtimin ndaj interesave kombëtare, por edhe ndaj përparimit të demokracisë e shtetit ligjor. Nderojnë dhe vlerësojnë kështu burrështetësin e rrallë, me karakter të fortë, që nuk iu dorëzua kurrë as pushtuesve dhe as koniukturave të politikës, por që triumfoi me dashurinë për jetën, atdheun dhe lirinë.

Si i tillë u vlerësua dhe u nderua Ai edhe të shtunën më 25 janar 2025 në veprimtarinë me temë “Alfred Moisiu – Një jetë në shërbim të kombit dhe paqes”, që u organizua me rastin e 95-vjetorit të lindjes nga Federata e Paqes Universale dhe Këshilli Rajonal i Paqes Tiranë.

Rreth 150 personalitete të nderuara, Ambasadorë për Paqe, drejtues të Federatës së Paqes Universale në nivel evropian dhe ndërkombëtar morën pjesë në këtë veprimtari të veçantë. Surpriza e veprimtarisë ishte ceremonia e vendosjes së emrit “Alfred Moisiu” sallës së konferencave të Ambasadës së Paqes, si vlerësim ndaj kontributit të jashtëzakonshëm të Presidentit Moisiu në rritjen dhe zhvillimin e Federatës së Paqes Universale në Shqipëri dhe Ballkan, dhe në veçanti për kontributin e tij për ndërtimin e Ambasadës së Paqes në Tiranë.

Veprimtarinë, të cilën e moderoi me mjeshtri të rrallë artistike Kryetari i Federatës së Paqes Universale Shqipëri, gazetari i mirënjohu. Defrim Methasani, e nderuan me prezencën dhe mesazhet e tyre në nder të Presidentit Moisiu, Presidenti i Malit të Zi (2003-2018) dhe njëkohësisht Presidenti i Klubit të Podgoricës Sh.T. Filip Vujanovic; Presidenti i Kosovës në vitet 2006-2010 Sh.T. Fatmir Sejdiu përmes një video mesazhi; Ish Kryeministri i Shqipërisë Sh.T. Wilson Ahmeti; Presidenti Ndërkombëtar i Federatës së Familjes Dr. Song Yong Cheon; Kryetari i Federatës së Paqes për Evropën Dr. Michael Balcomb; Kryetari i Tarikatit Halveti në Shqipëri Sheh Hysen Hormova; Presidentja e Federatës së Familjes Shqipëri Manjola Vasmatics; ish Kryetari i Federatës së Paqes Shqipëri në vitet 2011-2015, z. Bajram Ibraj; dhe Kryetari i Këshillit Rajonal të Paqes Tiranë z. Kastriot Selita.

Artisti dhe Mjeshtri i Madh Hysni Zela përshëndeti të pranishmit me dy këngë të mrekullueshme.

FILIP VUJANOVIÇ: MISIONI I PAQES LIDHI PRESIDENTIN MOISIU DHE UPF

Presidenti i Malit të Zi (2003-2018) dhe njëkohësisht Presidenti i Klubit të Podgoricës Sh.T. Filip Vujanovic, në këtë veprimtari mbresëlënëse shprehu respekt të veçantë



për presidentin Moisiu, të cilin tha se e njeh prej vitesh. Duke evidentuar partneritetin që filloi gjatë presidencës së tyre, ai tha se “Njoha gatishmërinë dhe vullnetin e Presidentit Moisiu për të afirmuar paqen, stabilitetin dhe prosperitetin midis Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe për të kontribuar në një situatë të qëndrueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kemi pasur shumë takime zyrtare dhe jozyrtare në Mal të Zi, Shqipëri dhe rajonin tonë. Njëpërmjet këtyre takimeve, personalitetet e rajonit e njohën Presidentin Moisiu si person të paqes”. Më tej Z.Filip Vujanovic vlerësoi misionin paqësor të Presidentit Moisiu, i cili ka qenë dhe është bashkëpunimi me UPF. Kjo për faktin se takimi i parë i UPF me presidentë nga vendet e Ballkanit Perëndimor ishte me Presidentin Moisiu dhe Misionin e Paqes lidhi Presidentin Moisiu dhe UPF.

Pasi falenderoi Presidentin Moisiu për njohjen e vlerave të FSHP-së dhe për mbështetjen e afirmimit të këtyre vlerave në rajonin tonë, Filip Vujanovic shprehu respekt për UPF, për aktivitetet e saj të forta, të dukshme dhe praktike në Ballkanin Perëndimor. Kjo sipas tij për faktin se UPF promovon me sukses paqen, dialogun, bashkëjetesën e diversitetit dhe të drejta të barabarta. “Mesazhi i rëndësishëm i UPF është se dallimet nuk duhet të na ndajnë apo të çojnë në konflikt. Përkundrazi, në dallimet tona, të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësi dhe trajtim të barabartë, duke e ditur se paqja është mbi të gjitha. Dëshmia më e mirë për këtë është Ambasada e Paqes në Tiranë”, tha Filip Vujanovic. Duke i uruar gjithë të mirat në ruajtjen e shpirtit rinor dhe të energjisë intensive, miku i tij, ish-kreu i shtetit malazez, vlerësoi vendimin për të emëruar sallën kryesore të Ambasadës së Paqes me emrin e Presidentit Moisiu, në ditën e ditëlindjes së tij, me bindjen se emri i kësaj sale do të na kujtojë se presidenti Moisiu i është përkushtuar paqes.

VLERËSIM, NDER, DETYRIM NJERËZOR DHE UNIVERSAL NDAJ PRESIDENTIT MOISIU

Veprimtaria e FPU Shqipëri dhe Evropë me temë: “Alfred Moisiu- Një jetë në shërbim të Kombit dhe Paqes”, ishte jo vetëm një vlerësim dhe nder, por edhe një detyrim njerëzor dhe universal ndaj Presidentit Moisiu.

Gjeneralmajor Bajram Ibraj, në fjalën e tij përshën-

detëse ndër të tjera vlerësoi se togjalëshi i përzgjedhur “...në shërbim të Kombit dhe Paqes...” është një gjetje e duhur. Parë nga ky këndvështrim ai solli në vëmendjen e pjesëmarrësve në këtë takim festiv momentin, kur, si dhe pse e ftua zoti Moisiu për President të Republikës. “Situationa politike pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 për shkak të problematikave të mëdha që ato shfaqën, ishte tejet e tensionuar, ku opozita bojkotoi kuvendin për gjashtë muaj për parregullsitë e konstatuara në këto zgjedhje sollën ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar. Dy palët jo miqësore Nano-Berisha u takuan me datë 17 mars 2002 dhe u arrit marrëveshja e parë e madhe politike për reformën zgjedhore dhe për zgjedhjen e një Presidenti në mënyrë konsensuale. Shumë emra në qarkullim, por një zgjedhje e suksesshme, prodhoi Presidentin Konsensual Zotin Alfred Moisiu”, tha Gjeneralmajor Bajram Ibraj. Më tej ai vlerësoi kapërcimim me maturi e vizion bashkëkohor të situatave konfliktuale, rolin e Moisiut në konsolidimin e shtetit ligjor, drejtimin e Këshillit të Sigurimit Kombëtar (KSK) nga Presidenti Moisiu në vitet 2002-2007 etj.

Në detyrën e Kryetarit të FPU në vitet 2011-2015, Gjeneralmajor Bajram Ibraj, tha se ruan kujtime pa fund për angazhimin, përkushtimin dhe mesazhet paqdashëse që ka dhene Presidenti Moisiu. Pasi foli për bashkëpunimin e ngushtë e frytëdhënës ai vlerësoi modelin e një shtetari dhe të një burri shteti, e kësajsoj Presidenti Moisiu është bërë një shembull frymëzues për të gjithë kombin tonë.



(Vijon në faqen 16)

LAMTUMIRA

Akademiku i mirënjohur ishte veteran i LANÇ dhe i arsimit të Kosovës

Minir Dushi, personalitet i shquar i shkencës dhe arsimit në Kosovë

Më 27 janar 2025, ndërroi jetë akademik Minir Dushi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) që nga themelimi i saj më 1975. Ai ishte pjesëmarrës aktiv në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. I rreshtuar me partizanët e Gjakovës, që kur ishte fëmi luftoi me pushkë në dorë kundër okupatorit nazi-fashist. Ishte pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit me detyrë në urën e Valbonës për të siguruar mirëmbajtjen e Konferencës.

Akademik Minir Dushi lindi në Gjakovë në vitin 1929. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme teknike e mbaroi në Nish (1950).

Studioi në Fakultetin e Xehetarisë në Beograd, ku u diplomua më 1958, ndërsa doktoroi po në Universitetin e Beogradit në vitin 1965.

Pas fakultetit punoi një kohë në horizontet e minierës së Trepçës, teksa më pas ushtroi funksione të ndryshme udhëheqëse në këtë kombinat.

Akademik Minir Dushi ishte njëri nga themeluesit dhe drejtues i disa institucioneve mësimore dhe

OVLANÇ TË KOSOVËS DO TA KUJTOJË ME KRENARI XHAFER HAXHIJAKUPIN

Më 25 janar 2005 u nda nga jeta Xhafer Haxhijakupi, veteran i LANÇ që nga viti 1942 dhe anëtar i Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës.

Familja, miqtë, antarët e Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe të degëve të saj në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë e Gjilan bashkë me të gjithë të njohurit e tij, ndihen të pikëlluar për humbjen e një njeriu të mirë dhe përfaqësuesin dinjitoz të organizatës.

Veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre do ta kujtojnë me krenari bacën Xhafer dhe veprën e tij do na mungojë shumë të gjithëve, por kujtimi i tij do të jetë vazhdimisht i pranishëm në punën dhe jetën tonë.

Në situata të rënda dhe të vështira për shqiptarët në Kosovë kur regjimi serb sulmonte edhe veteranët e LANÇ, Xhafer Haxhijakupi tregoi vendosmëri në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë.

Në gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, kur u bë edhe përjashtimi i veteranëve shqiptarë nga SHVLANÇ me ndërhyrjen e politikës shkatërrimtare të Sërbisë, ai ishte njëri ndër ata që publikisht u deklarua se nuk pajtohet me situatën e krijuar.

Kundërshtoi politikën okupuese të Beogradit dhe bashkë me kuadrot tjerë më 17 qershor 1997 organizuan Kuvendit Themelor të SHVLANÇ të Kosovës.

Xhafer Haxhijakupi veçmas u angazhua në përmirësimin e gjendjes materiale të shoqatës.



shkencore të Kosovës, siç ishin Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë (1961-1966), Instituti i Plumbit dhe i Zinkut i Kombinatit "Trepça" (1966-1973), Fakulteti i Xehetarisë dhe i Metalurgjisë në Prishtinë (1970) e më vonë në Mitrovicë (1975-1979).

Në vitin 1969 u zgjodh profesor inordinar i Fakultetit Teknik të Prishtinës, ndërsa në vitin 1975 profesor ordinar i Fakultetit Xehetaro-Metalurgjik në Mitrovicë, ku ushtroi edhe detyrën e dekanit për dy mandate. Me themelimin e Universitetit të Prishtinës (1970) u zgjodh zëvendësrektor i parë, kurse në vitin 1981 u bë rektor i këtij universiteti (1981-1983). Anëtar korrespondent i ASHAK-ut u zgjodh që nga themelimi i Akademisë në vitin 1975, kurse në vitin 1978 u zgjodh anëtar i rregullt. Në vitin 1986 u bë anëtar i Kryesisë së KSA të Kosovës.



Gazmend Hoxha duke folur në emër të kryetarit të OVLANÇ të degës në Kosovë

- Ka të botuara 18 libra shkencorë, nga të cilët 4 tekste universitare, si dhe 14 vepra të tjera të veçanta të botuara nga ASHAK-u dhe Universiteti i Prishtinës. Akademik Minir Dushi është nderuar me një sërë çmimesh, dekoratash dhe mirënjohjesh

Opusi shkencor i akademik Minir Dushit arrin mbi 180 njësi bibliografike. Nga fusha e xehetarisë ka botuar 8 vepra e afro 70 punime shkencore dhe profesionale. Ka të botuara 18 libra shkencorë, nga të cilët 4 tekste universitare, si dhe 14 vepra të tjera të veçanta të botuara nga ASHAK-u dhe Universiteti i Prishtinës.

Akademik Minir Dushi është nderuar me një sërë çmimesh, dekoratash dhe mirënjohjesh.

Ishte veteran i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe ishte shpallur edhe veteran i arsimit të Kosovës.

Në 25-vjetorin e Universitetit të Prishtinës, Senati i këtij universiteti i dha titullin "Profesor emeritus", kurse Këshilli Shkencor-Mësimor i Fakultetit Xehetaro-Metalurgjik në vitin 1996 e shpalli "Dekan nderi".

Në respekt të jetës dhe veprës së akademik Minir Dushit, më datë 28 janar 2025 u bënë homazhe në Shtëpinë e Kulturës "Rexhep Mitrovica".

Më 29 janar (e mërkurë) në orën 10:00, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhje komemorativë dhe më pas, po në mjediset e Akademisë, u zhvilluan homazhe, deri në orën 11:30.

Në orën 11:30 kortezhi u nis për në Gjakovë.

Në Gjakovë, në Shtëpinë e Kulturës "Asim Vokshi", nga ora 14:00-15:00 u mbajt të mbledhje komemorativë. Akademik Minir Dushit iu dha lamtumira e fundit me te gjitha nderimet që meritonte për t'u prehur i qetë në varrezat e vendlindjes së tij, në Gjakovë.

Bashkim HISARI



Mesazh ngushëllimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Trashëgimia akademike e Minir Dushit, pasuri e çmuar për brezat e ardhshëm

I nderuar akad. Mehmet Kraja, të dashur kolegë,

Me dhimbje të thellë Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përcjell ngushëllimet për ndarjen nga jeta të akademik Minir Dushit, një figurë madhore e shkencës dhe arsimit në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare.

Akademik Minir Dushi ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e xehetarisë dhe metalurgjisë, si dhe ka luajtur një rol kyç në themelimin dhe drejtimin e institucioneve të rëndësishme shkencore dhe arsimore në Kosovë.

Trashëgimia e tij akademike mbetet një pasuri e çmuar për brezat e ardhshëm, ndërsa veprat dhe përkushtimi i tij ndaj arsimit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme, duke ndihmuar në vendosjen e themeleve për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe

kërkimit shkencor në vend. Roli i tij në themelimin dhe forcimin e Universitetit të Prishtinës përbën një tjetër arritje madhore që do të kujtohet ngahera. Si zëvendësrektor i parë dhe më pas rektor i këtij institucioni, ai e drejtoi atë me vizion dhe përkushtim, duke kontribuar në ngritjen e standardeve akademike dhe në edukimin e një brezi të ri shkencëtarësh dhe profesionistësh të talentuar.

Në këtë moment pikëllimi, ne bashkëndajmë me ju dhe familjen e Tij dhimbjen për këtë humbje pa kthim. Kujtimi dhe vepra e akademik Minir Dushit do të mbeten gjithmonë frymëzim për të gjithë ata që i shërbejnë dijes e përparimit shkencor. Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Tiranë,

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë, 27 Janar 2025

IN MEMORIAM

Historia e gjeneralit të famshëm që u internua dhe u burgos nga dikatura

Tahir Kadareja, njeriu dhe ushtaraku me përmasat e një personaliteti

Më 1949-ën, Tahir Kadareja fiton gradën gjeneral-major dhe më pas caktohet në krye të Komandës së Artilerisë të Ushtrisë Shqiptare.

- Në Konferencën e Tiranës (1956), ai u godit ashpër, krahas disa ushtarakëve të lartë, për mendimet që shpalli haptas ndaj udhëheqjes së lartë të partisë e të shtetit të asaj kohe. Më pas vijë internimi në Kuçovë e pastaj, si një asket të shkretë, e mbyllin në Zvërnec, ku edhe e burgosin. Kaq i mbyllur, gati hermetik, dhe i frikshëm jo vetëm nga shokët e miqtë, por edhe nga njerëzit e afërt, sa këta e kishin të pamundur ta takonin.

Nga Vangjel Kasapi

Familja gjirokastrite e Kadareve, nuk është e njohur vetëm për shkrimtarin me famë botërore Ismail Kadarenë. Në dhjetëvjeçarën e dytë të këtij shekulli, njëra nga degët e këtij fisi, ajo e familjes së Sadik Kadaresë, do ta bëhej e njohur, sidomos gjatë Luftës Antifashiste dhe në vitet e para të pas çlirimit, me ushtarakun Tahir Kadareja, gjeneral i dimensioneve operativo-strategjike, intelektual me horizont gjitharmësh të kompletuar, i njohur për bindjet e tij kundra regjimit monist diktatorial. Kadaretë kanë dalluar, jo vetëm për atdhetarizmin dhe ndjenjën e përkushtimit ndaj çështjes së lirisë dhe të Shqipërisë, por edhe për kulturën dhe talentin e tyre të veçantë.

KUSH ISHTE TAHIR KADARE?

Tahir Kadareja lindi më 28.11.1913 në qytetin e gurtë të Gjirokastrës. Arsimin fillestar e mori në qytetin e lindjes, po ashtu edhe atë të mesëm. Pas kësaj vjen në Tiranë, ku hyn në Shkollën e Oficerëve, të cilën e përfundoi në gusht të 1931-shit, në degën e artilerisë, si oficer me gradë aspirant. Pas vitit 1933, Tahir Kadareja fitoi gradën nëntoger.

Fillimisht caktohet me punë pranë Komandës së Artilerisë së Ushtrisë, ku shërbeu deri në vitin 1935. Duke qenë njeri përparimtar dhe me kërkesa ndaj vetes dhe regjimit, si njeri që kërkonte ecjen përpara të vendit me hapat e kohës, ai shpejt bëhet kundërshtar i regjimit shtetëror dhe, për rrjedhojë, edhe pjesëtar aktiv i lëvizjes anti-monarkiste të Fierit (1935), të cilën e udhëhiqte koloneli shumë i njohur në historinë e Ushtrisë dhe të Shqipërisë, Ali Shefqeti (Shkupi).

Meqenëse kjo lëvizje shpejt u shtyp nga regjimi në fuqi, Kadareja, së bashku me disa ushtarakë të tjerë pjesëmarrës në të, burgoset dhe më pas internohet në Tepelenë. Për pasojë, humbet të drejtën e gradës dhe përjashtohet nga Ushtria, me Dekretin shtetëror të datës 12.11.1937, së bashku me Dali Ndreun dhe Bedri Spahiun.

Por, për të mos iu nënshtrua kësaj gjendjeje ai, tok me Mustafa Matohitin ("Hero i Popullit", dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare), edhe ky me karrierë në Ushtrinë Mbretërore Shqiptare të kësaj periudhe, arratisen në Greqi. Në prill të 1939-s, Shqipëria u pushtua nga fashistët italianë dhe në vend, si kundër reaksion, lindi Lëvizja Antifashiste.

Një nga ish-ushtarakët e parë që u përfshi në këtë lëvizje kombëtare dhe që ndihmoi ndjeshëm për rritjen dhe fuqizimin, për konkretizimin e saj me formacione dhe veprimtari luftarake kundër pushtuesit të huaj në Qarkun e Gjirokastrës, ishte pikërisht Tahir Kadareja. Ai u mor me përgatitjen e luftës dhe të formacioneve luftarake, që nga më të voglat deri te më të mëdhatë, duke u bërë kështu një nga drejtuesit më të njohur dhe më kryesorë në qark dhe në tërë Jugun e Shqipërisë.

Pas gjithë kësaj veprimtarie të tij, nisin të spikatën edhe kultura e aftësitë ushtarake, talenti si drejtues



- Shkrimtari Ismail Kadare, në një nga botimet e tij (1992, në Francë, ku ndër të tjera shkruan se: "Gjeneral Tahir Kadareja, ka qenë gjatë viteve të para të luftës, më i njohur se Enver Hoxha dhe ndoshta një nga arsyet e mllefrit të paqartë të këtij të fundit ndaj tij, ka qenë thjesht ndjenja e zilisë, për njëfarë legjende që ende vazhdonte për të, midis partizanëve të vjetër".

dhe organizator i shquar, gjakftohtësia, shpirti luftarak dhe humanizmi, guximi dhe besnikëria ndaj idealit të cilit i ishte përkushtuar dhe për të cilin luftonte. Me atë buzëqeshjen e qetë dhe shikimin e vëmendshëm, që shprehte thellësinë dhe sinjeritetin e shpirtit dhe të botës së tij të brendshme, Tahir Kadareja, rrezatonte njëherësh besim dhe miqësi për shokët dhe bashkëpunëtorët e tij, duke ua lehtësuar realizimin e detyrave të vështira e plot rreziqe të luftës.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë, sapo formohet formacioni i parë i madh, Brigada I-rë Sulmuese, Tahir Kadaresë i besohet një detyrë e rëndësishme në drejtimin e brigadës, zëvendëskomandant i saj. Këtu Tahir shpalosi cilësitë drejtuese si ushtarak i mirëfilltë, për drejtimin e veprimeve luftarake të këtij formacioni të shquar të UNÇSh-së.

Për këto cilësi, menjëherë pas krijimit të Brigadës VI-të Sulmuese (janar 1944), caktohet nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSh-së, komandant i saj. Ai e drejtoi brigadën në valën e luftimeve të ashpra dhe të fitoreve kundër pushtuesve nazistë, luftime të njohura në historinë e UNÇSh-së dhe të popullit tonë.

Veçohen e spikasin mes tyre veçanërisht veprimet gjatë Operacionit të Dimrit 1943-1944, si dhe në Operacionin nazist të Qershorit 1944. Por nuk harrohen kurrsesi edhe veprimet e ashpra e të përgjakshme në Labinot, Pukë e, deri në Vishegrad të ish-Jugosllavisë. Në to dhe në shumë veprime të tjera luftarake, Tahir Kadareja udhëhoqi me aftësi luftarake dhe me fantazi në krye të Shtabit të Brigadës. Për rrjedhojë, ai pati një karrierë të shpejtë.

Sapo krijohet Divizioni II-të Sulmues (4.8.1944), përsëri Tahirit i besohet komanda e divizionit, ndërsa më 18 nëntor të këtij viti, ngarkohet komandant i Korparmatës së Dytë, që ishte formacioni i dytë më i madh i Ushtrisë NÇSh. Kaq i vërtetë dhe real është ky vlerësim për aftësitë e tij, sa që e vërtetojnë edhe vetë nazistët, në një dokument sekret të fundvitit 1943, që vlerëson e kategorizon grupet e rezistencës antifashiste në Shqipëri.

Në të shkruhej se; "Bedri Spahi dhe Tahir Kadareja, ishin mjaft të aftë", natyrisht që nënkuptohet ushtarakisht. Çlirimi i Shqipërisë e vuri Kadarenë përballë një të ardhmeje dhe punësh të reja. Ky ishte një kapitull i ri, por me mjaft sfida. Pak kohë pas çlirimit të vendit, ai dërgohet me studime të larta në Akademinë Ushtarake "Voroshilov" në Moskë, të cilën e përfundon me rezultate të shkëlqyera.

Për këtë dhe aftësitë që zotëronte, si dhe për arritjet gjatë Luftës Antifashiste, u caktua me detyra deri në postin e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm, të Ushtrisë Shqiptare. Më 1949-ën, Tahir Kadareja fiton gradën gjeneral-major dhe më pas caktohet në krye të Komandës së Artilerisë të Ushtrisë Shqiptare.

Arritjet ishin të merituar, ato vinin vetëm falë cilësive, aftësive profesionale, karakterit të tij të fortë, dinjitetit dhe autoritetit që gëzonte mes eprorëve të vartësit dhe të popullit. Veçanërisht ai respektonte mendimet dhe opionencën e vartësve të tij, për çdo problem që lidhej me punën. Nën gradat e gjeneralit, Kadareja fshihte një numër vlerash, të cilat ia njihnin dhe i respektonin shokët dhe bashkëpunëtorët e tij.

Ata e çmonin shumë, teksa shpreheshin se ai ishte një ndër udhëheqësit më të përgatitur, më të ndershëm dhe më të shquar ushtarakë të Luftës Antifashiste. Pas luftës, Tahir Kadareja u vlerësua si një nga ushtarakët më të përgatitur, veçanërisht në lëmin e artilerisë, që ndikoi dhe ndihmoi ndjeshëm në organizimin, fuqizimin dhe modernizimin e saj.

Porse gjeneral Kadareja, kishte edhe një vlerë të veçantë, por; të "keqe për të mëdhenjtë". Duke u shquar për karakterin e tij të qëndrueshëm, i drejtë, me plot arritje dhe mjaft i aftë në punën e tij, parapëlqente t'i shpaloste hapur mendimet.

Kjo shumëkujt atje lart, nuk i pëlqente. Emri dhe reputacioni i arritur gjatë luftës, niveli i detyrave dhe gradat, por sidomos fjala e tij e hapur dhe e vërtetë, pikëpamjet e tij shpesh me kah të kundërt, nga ato të udhëheqjes së lartë partiake ose shtetërore të kohës,


(Vijon në faqen 12)

HISTORIA

Sipas kujtimeve të ish nënkryetarit e kryetarit të OBVLP, kolonel Myfit GUXHOLLI

81 vjet më parë - Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

Faqe të lavdishme nga lufta heroike e Ushtrisë Nacionalçlirimtare



Në fundin e vitit 1943, Ushtria Nacionalçlirimtare ishte rritur e forcuar dhe godiste pa pushim armikun. Në këtë kohë, e favorizuar dhe nga kushtet e jashtme si fitoret e Ushtrisë Sovjetike dhe të Aleatëve, Ushtria Nacionalçlirimtare kishte çliruar edhe mjaft qytete si Dibra, Peshkopia, Kruja, Berati, Gjirokastra dhe harta e territoreve të çliruara po shtrihet deri në Vlorë. Po rrezikoheshin rrugët e Lëvizjes së Ushtrisë Naziste. Kjo gjendje e shqetësonte shumë komandën gjermane. Në këto kushte, kryekomandanti i forcave naziste gjermane deklaronte: "Deri tani ne i kemi besuar mikpritjes dhe besës shqiptare, por nuk mundemi të durojmë më gjatë sulmet; duhet të marrim masa për sigurinë tonë". Në të njëjtën kohë, qeveria tradhtarë e Tiranës, u vu drejtpërdrejt në shërbim të okupatorit dhe mobilizoi forcat e veta për të asgjësuar forcat partizane.

Gjermanët iu vunë punës për përgatitjen e një operacioni ushtarak të përgjithshëm në Shqipëri. Qëllimi i këtij operacioni synonte asgjësimin e UNÇL dhe shkatërrimin e këshillave Nacionalçlirimtare, për të vendosur pushtetin e bashkëpunëtorëve të tyre.

Forcat naziste gjermane që vepronin në Shqipëri u përforcuan me forca të tjera të ardhura nga Greqia e Jugosllavia dhe që hynin në përbërjen e katër divizioneve gjermane (297, 181, 21, 104.) Efektivit i këtyre forcave armike arrinte rreth 30.000 veta, përveç afro 12.000 forca të Ballit Kombëtar e Legalitetit. Komandanti i Përgjithshëm i Operacionit ishte gjenerali nazist Fehm.

Ndërsa forcat e UNÇL arrinin rreth 20.000 luftëtarë; shumica e tyre të

inkuadruar në batalione, grupe e brigade të rregullta (4 brigada, 9 grupe dhe 17 batalione). Armatimi i tyre ishte i thjeshtë: pushkë automatike, mitraloza të lehtë e të rëndë. Burimi kryesor i furnizimit të forcave partizane me veshmbathje, ushqim dhe municion ishte populli ndërkohë që llogaritej edhe furnizimi nga aleatët dhe kapja në luftë e depove dhe materialeve të ndryshme të armikut. Ajo kishte moral shumë ta lartë dhe disiplinë të shëndoshë e të ndërgjegjshme sepse partizanët luftonin për një gjë të shenjtë, çlirimin e atdheut. Komanda gjermane, pasi kishte përpunuar planin e operacionit dhe kishte bërë përgatitjet e nevojshme filloi nga zbatimi i tij qysh në Nëntor 1943 duke sulmuar UNÇL në zonën e Pezës dhe pastaj me radhë në zonat e Dibrës, Mallakastrës, Çermenikës, Shëngjergj-Martanesh, Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Kurvelesh-Salari-Mesaplikut. Pas disa goditjeve të vogla, komanda gjermane nazifashiste, kolaboracionistët e armatosur deri në dhembë goditjen kryesore e dhanë kundër forcave të Brigadës së 3-të dhe Grupit të Pezës. Forcat armike sulmuan nga drejtimet: Tirana, Ndroqi, Shijaku, Kavaja, Rrogozhina e Peqini me qëllim rrethimin dhe asgjësimin e forcave partizane. Këto të fun-

dit, megjithëse të armatosura me armë të lehta, pa ushqime dhe veshmbathje, në kondita dimri luftuan me trimëri të rrallë.

Shtabi i Përgjithshëm, duke vlerësuar rezistencën e armikut vendosi që Brigada e 3-të të kalonte në zonën e Çermenikës duke manovruar për të çarë rrethimin. Në të njëjtën kohë, Grupi i Pezës u urdhërua të luftonte me grupe të vogla kundër forcave armike të dislokuara në zonën e Pezës. Ushtria nazifashiste mundi të përshkonte zonën e Pezës gjatë operacionit. Këtu ajo dogji, vrau e shkatërroi, por partizanët e Pezës nuk mundi t'i asgjësonte.

PARTIZANËT I ZBATUAN ME PËRPIKËRI DETYRAT

Pas operacionit të Pezës, okupatorët nazistë kryen sulme kundër forcave partizane të Dibrës e Peshkopisë. Edhe këtu partizanët luftuan me trimëri, por në pamundësi manovrimi në ato zona, detashmentet partizane në kondita të disfavorshme karshi armikut marrin urdhër për tu tërhequr dhe të kalonin në drejtim të Shqipërisë së Mesme e të Jugut. Njëkohësisht edhe zona e Tropojës nuk shpëtoi nga operacioni duke u sulmuar nga forcat gjermane dhe ato të Xhaferr Devës, të cilat pasi e shkelën, e dogjën, plaçkitën popullin, arrestuan dhe rrahën në gjithë zonën e Malësisë.

Operacioni në krahinën e Mallakastrës u krye me forca të mëdha. U pushtua Berati dhe u vazhdua për në drejtim të Mallakastrës ku ishte përqendruar njësisia më e madhe luftarake e UNÇL për atë kohë, Brigada I Sulmuese. Forcat gjermane në bashkëpunim me ato kolaboracioniste sulmuan në drejtim të Fierit e Beratit. Në Gllavë sulmuan forcat kolaboracioniste së bashku me ato naziste gjermane. Pra, forcat partizane ishin të rrethuara nga të gjitha anët. Mjaftonte një gabim i vogël dhe forcat partizane të asgjësoheshin. Komanda e Brigadës I Sulmuese, nën drejtimin e shokut Mehmet Shehu e vlerësoi drejt situatën

dhe mori vendimin për të dalë nga rrethimi që po i përgatiste armiku. Partizanët zbatuan me përpikëri detyrat dhe duke përdorur Lundrën e Vogël të Memaliaj kaluan lumin Vjosë për në krahinën e Mesaplikut. Në operacionin e krahinës së Mesaplikut e të Kurveleshit të Poshtëm, forcat e Brigadës I Sulmuese dhe ato të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastrë zhvilluan luftime të përgjakshme, duke i shkaktuar humbje të mëdha armikut në Vajzë, Gjorm e Qafa e Shëngjergjit. Forcat partizane, duke mos dashur të angazhoheshin në luftime të gjata frontale përpara një armiku superior në forca e mjete, me një manovrim të shpejtë u tërhoqën nga pozicionet e para dhe zunë vijën Bolenë-Vranisht duke zhvilluar luftime të rrepta. Njëkohësisht ato kaluan në zonën e Kurveleshit të Sipërm. Më vonë, forcat kryesore të Brigadës manovruan në zonën e Zagorisë e Lunxhërisë. Një pjesë e tyre u bashkuan me forcat partizane të Qarkut të Vlorës duke kaluar prapa krahëve të armikut për tu kthyer përsëri në Mesaplik e Kurvelesh duke pastruar këto zona nga kolaboracionistët dhe armiku nazist.

Çarja e rrethimit në malet e Martaneshit e Çermenikës

Në 15-ditshin e dytë të Dhjetorit 1943, forca të shumta naziste gjermane dhe kolaboracioniste filluan operacionin kundër forcave partizane që vepronin në zonën Çermenikë-Shëngjergj-Martanesh. Para se të fillonin operacionin bënë disa goditje kundër partizanëve dhe përforcuan pozitat e tyre gjatë rrugës automobilistike Qafë e Thanës-Elbasan-Tiranë. Qëllimi i armikut ishte që forcat partizane të Brigadës 2-të e 3-të, si dhe batalionet e Çermenikës e Martaneshit të mbeleshin të izoluar dhe të asgjësoheshin. Me këto forca partizane ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm. Ishte rasti që Shtabi i Përgjithshëm të tregonte më së miri organizimin e këtyre luftimeve kundër forcave të shumta armike të armatosura më së miri.. Ai duhej të grumbullonte forcat e dy brigadave, asaj të 2-të e të 3-të si dhe të batalioneve të Martaneshit e Çermenikës në një komandë të vetme dhe të luftonin duke sulmuar e mbrojtur që të mund të çanin rrethimin. Por Shtabi i Përgjithshëm, sidomos Enver Hoxha vetë i katërt vendosi të largoheshin në Jug të vendit, në zonën e Polisit. Ndërsa forcat partizane u lanë në dorë të shtabeve të tyre duke rrezikuar edhe shpërbërjen. Këto forca partizane luftuan me trimëri dhe vetëmohim për të çarë rrethimin dhe me manovër të shpejtë arritën të shkëputeshin nga forcat gjermane dhe ato kolabora-

(Vijon në faqen 12)



AKTUALITET

Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare

FARSH, vlerë e shtuar e Aleancës

Në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë, në luftë kundër terrorizmit, Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare, në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike. Më 9 shtator 1996, FARSH-të kanë filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë.

Numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione. Pjesëmarrja e FARSH-ve në misione paqeruajtëse dhe luftarake buron nga misioni kushtetues i FARSH-së dhe baza ligjore e përcaktuar për secilin kontribut në misione paqeruajtëse apo luftarake. Kontribute të FARSH, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin dhjetor 2023 (grafiku), janë gjithsej 8622 ushtarakë.

Me rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike brenda vendit, Forcat e Armatosura nga viti në vit po rrisin edhe kontributin në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, jo vetëm sa i përket numrave, por edhe hartës së angazhimeve ushtarake në mbështetje të paqes anembanë globit. Në vitin 2025, FA do të ketë prani të shtuar me 50 trupa në misionet e KFOR-it në Kosovë, ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë, NSATU dhe Operacionin "Interflex", dy të fundit në mbështetje të Ukrainës, duke konfirmuar dinamizmin e angazhimeve të Shqipërisë në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në botë.

Forcat e Armatosura kanë qenë pjesë e operacioneve dhe misioneve paqeruajtëse përkrah aleatit tonë strategjik NATO. Për vitin 2015, niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës, parashikon një shifër totale prej 286 ushtarakësh (pa llogaritur rotacionet e misioneve). Për vitin 2016 niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës ka qenë 413 ushtarakë (pa llogaritur rotacionet e misioneve çdo 6 muaj). Për vitin 2017 niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës parashikohet të jetë 619 ushtarakë. Për vitin 2018, përveç kontributeve aktuale, ministri i Mbrojtjes ka miratuar shtimin e kontributit të FARSH me 52 ushtarakë në operacionin "RSM", në Afganistan dhe 3 ushtarakë në Prezencën e Përparuar të Përforcuar të NATO-s (eFP) në Letoni. Nëntor 2019 niveli i angazhimit në operacione dhe



misione ndërkombëtare është si vijon: në "RSM", Afganistan vijon kontributi i FARSH me 132 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 29 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 1 ushtarak; "EUTM Mali", vijon kontributi i FARSH me 4 ushtarakë; "Aegean Sea" në detin Egje vijon kontributi me 22 ushtarakë; në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 21 ushtarakë; në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë (kontribut i shtuar gjatë vitit 2019).

Në dhjetor 2021 në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 21 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 27 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 1 ushtarak, në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë. Në dhjetor 2022 në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 82 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 170 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë, në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë; në Novo Selo, Bullgari vijon Aktiviteti i Vigjilencës së Përforcuar (enhanced Vigilance Activity - eVA) me 60 ushtarakë; në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit në Misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (Multinational Force and Observations MFO) me 3

ushtarakë; në operacionin ushtarak UNMISS në Sudanin e Jugut, në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 4 ushtarakë. Më 25 qershor 2023 ka filluar kontributi i Forcave të Armatosura në Misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (Multinational Force and Observations - MFO) në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit, me rotacion 1 - vjeçar me 3 ushtarakë nga Policia Ushtarake. Duke filluar nga 29 nëntor 2022, FARSH është angazhuar në Aktivitetin e Vigjilencës së Përforcuar (eVA) në Novo Selo, Bullgari. Kontingjenti i FARSH-së, i përbërë nga 30 ushtarakë, dislokohet në përbërje të Grupbatalionit të NATO- në kufijtë lindorë të Aleancës. Vend drejtues i këtij misioni është Italia. Rotacioni i kontingjenteve është çdo 6 muaj. Vijon kontributi i FARSH-së në operacionin ushtarak United Nations Mission In South Sudan - UNMISS në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB me 2 ushtarakë, kontribut i shtuar gjatë vitit 2019. Në total 10 ushtarakë. Shtohet në gusht 2023 kontributi i FARSH-së, me 1 efektiv të FARSH-së, rotacion 1- vjeçar në UNISFA, zona Abeyi. Duke filluar nga qershori i viti 2017, FARSH është angazhuar me një togë EOD si pjesë e grup - batalionit kanadez të Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO (eFP) në Letoni të përbërë nga 18 ushtarakë. Ministri i Mbrojtjes ka miratuar shtimin e kontributit të FARSH me 3 ushtarakë në eFP në Letoni. Vijon kontributi i FARSH gjatë vitit 2022 në operacionin e NATO-s në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP), Riga, Letoni me 41 ushtarakë. Vijon kontributi i FARSH-së gjatë 6-mujorit të parë 2023 në operacionin e NATO-s në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP), Riga, Letoni me 44 ushtarakë dhe konkretisht: 1 togë EOD në BG kanadez, me 20 ushtarakë, 1 pozicion në HQBG kanadez, 1 pozicion në Rajonin e 3 të AÇI, në Letoni. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u angazhuan në operacionin ushtarak të NATO-s "Aegean Sea", në nëntor 2016, në detin Egje me 1 (një) anije e klasit "Iliria" dhe një ekuipazh prej 21 ushtarakësh. Misioni, është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, Standing NATO Maritime Group 2 (SNMG2), në detin Egje, në kuadër të operacionit të NATO "Aegean Sea". Kontributi i i FARSH-së, duke filluar nga 21 nëntori 2016 dhe deri më nëntor 2019 është 302 ushtarakë. Gjatë 2023 rifillon kontributi i FARSH rotacion me periudhë 3 - mujore në "Aegean Sea" me 1 (një) anije e klasit "Iliria" dhe një ekuipazh prej 21 ushtarakësh.



SUPLEMENTI LETRAT

“SHTËPIA E VERDHË”, PROTESTA E MEREMES NDAJ CARLA del PONTE

...dhe një tufë ferrash në varrin e Dick Marty, nga Destani, i Zoti i Shtëpisë...

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Meremja, zonja e të famshmes “Shtëpia e verdhë”, vetëm dy herë në jetën e saj kishte zbritur në qytet. Herën e parë, me bashkëshortin Destanin, për të ngrënë një akullore dhe për të parë një film...Një herë tjetër, shumë vite më vonë, kishte zbritur për një panair artizanati, ku ajo kishte paraqitur çorapet me motive të vjetra dhe trikot me figura si kristale bore që ajo dinte t'i thurte fare mirë. Por kur mori vesh se shtëpia e saj ishte njosur nga një juriste zvicerane dhe kryeprokurorja e OKB-së për krimet e luftës, mori vendimin të shkonte ta takonte Karla del Ponte-n. “Do të shkonte t'ia përplaste në fytyrë të vërtetën asaj gruas së ashpër që kishte vënë gishtin mbi ta për t'u dhënë një damkë që nuk e meritonin”.

Bashkim Hoxha, ndër shkrimtarët më produktivë e cilësorë në romanin e tij “Shtëpia e verdhë” e përçon tek lexuesi mjaftë bukur artistikisht brengën e gruas që nuk e mbante vendi pa vënë në vend drejtësinë. Nëpërmjet një trilli artistik befasues, autori përshkruan “arratisjen” e Meremes nga “Shtëpia e verdhë” për të kapur makinën e parë që zbriste në qytet dhe më tej për në Tiranë me autobuzin e linjës. Me bashkëudhëtarën, Nora, “Në Tiranë, në ambasadën zvicerane, nuk i lanë të afroheshin.... Pastaj shanë sa mundën ata lart që nuk e kishin fare mendjen tek ata, të thjeshtët, të paemrit”. Kësisoj, individualiteti krijues i romancierit të mirënjohur Bashkim Hoxha vjen përsosmërisht në episode befasuese të romanit më të kërkuar e të preferuar nga lexuesi shqiptar, jo vetëm i Tiranës e Durrësit, por edhe i Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit, Mitrovicës e i gjithë hapësirës mbarëshqiptare në botë. Kjo për faktin se është i vetmi që i ofron lexuesit kryeveprën “Shtëpia e verdhë”, si aktakuzë ndaj atyre që guxuan të njollosin luftën legjendare të UÇK-së dhe të keqpërdoren nga eksponentë vampire të qarqeve më të errëta shovene serbe, duke sajuar një shtëpi të një fashati malor, qindra kilometra larg aeroportit të Rinastit, të palidhur me rrugë normale automobilistike, si qendër të trafikimit të organeve. Kësisoj, si rrallëkush në fushën e letrave, Bashkim Hoxha krijon një trashëgimi letrare shumëpërmasore, në një roman kryeveprë, ku letrari zon mjaftë bukur “histori të tilla që kanë bërë të bjerë edhe besimi i gazetave”.

LIBRI ME KUJTIME DHE RAPORTI I CARLA del PONTE, MBI PROVA TË PABESUESHME

Është vërtetë tronditës dialogu i personazheve realizues të filmit: Viktorit, Feliksit e Loshos së ngazëllyer, ngaqë amerikanët kanë pranuar të bëjnë film romanin e tij për trafikun e organeve. Nëpërmjet një rrëfimi mjeshtëror, Bashkim Hoxha vë në gojën e Loshos Vujeviçit fjalë që vrasin. Sepse, nisur nga shpifje gazetareske ai



e quan luftën në Kosovë një mizori të patreguar (fq. 81). “Për trafikun e organeve në shtëpinë e verdhë ai kishte mësuar, së pari, nga një miku i tij zyrtar i lartë në shërbimet sekrete, që kishte hetuar dhe gjurmuar trafikun e bërë nga ushtarët e UÇK-së...Miku i tij kishte zbuluar se nga buronin paratë për të blerë raketa. Shqiptarët shisnin organe njerëzish dhe blinin armë në tregun e zi”. (fq. 80). Këto shpifje monstruoze, Carla del Ponte shkroi librin e saj të kujtimeve (dhe më pas edhe në Raportin famëkeq për Këshillin e Europës, edhe pse ajo deklaroi se nuk kishte gjetur prova të besueshme. Por ndonëse ajo shkoi në botën e përtejme e damkosur me njollë turpi, bazuar në shpifjet e saj, disa nga komandantët e UÇK-së janë tashmë në burg me akuza absurde. “Shumë veta nuk e besojnë të kenë ndodhur krime të rënda si trafikimi i organeve, por lufta nuk mund të gjykohej me logjikë normale. Në luftë ndodhin gjëra nga më të tmerrshmet, në kohë lufte, fantazia e veprimeve është mjaftë e ndezur”, shkruan autori B.Hoxha (fq.81). Parë nga ky këndvështrim ai, edhe fotoreporterin Feliski, ja prezanton lezuesit si njeriun që “...e kishte marrë me mosbesim, si një trillim letrar, historinë (e sajuar) që ushtarët e UÇK-së luanin futboll me koka njerëzish...” Të kësaj sere i profilizon autori në këtë roman edhe nobelistët (serbë) e kësaj zone që suksesin e kanë arritur duke rrëmbyer legjendat e një populli tjetër... dhe duke bërë luftë edhe për simbolet. (fq.105).

HISTORI ROMANTIKE QË KULLOJNË GJAK

Përkundër trillimeve të skenaristit të filmit për të famshmen “Shtëpia e verdhë”, Bashkim Hoxha ka meritën e

evidentimit nëpërmjet fjalës artistike të masakrave serbe në Kosovën martire. Mjafton të perifrazojmë regjisorin Ben Kaçaniku që kishte qenë 11 vjeç kur në rreshtin e gjatë që priste të kalonte kufirin ndodhej me nënën dhe vëllain e tij më të vogël. Ishte një rresht i gjatë njerëzish të lebetitur, i bllokuar nga policët serbë që me armë në dorë kontrollonin kolonën e ikanakëve, duke nxjerrë nga rreshti burrat.

“Në kufi dy policët serbë vunë një bast për një grua shtatzënë. Njëri thoshte është djalë, tjetri thoshte është vajzë. I çanë barkun me bajonetë dhe fitoi ai që tha se ishte djalë. Kishin vënë bast me një birrë dhe një panine me pesë qebapë...Në fshatin tim, në një ditë u vranë 23 veta. I hodhën në një gropë të përbashkët. Pas luftës deshën t'i zhvarrosnin e t'u bënin secilit nga një varr, por trupat e tyre ishin ndërthurur me njëri - tjetrin dhe ngritën vetëm një monument mermeri mbi varrin e përbashkët”...

Mjaft tronditës në romanin e B.Hoxhës edhe tregimi i Albanit për Bekimin. “Policët serbë që kishin ardhur t'i nxirrnin nga shëpia e goditën atë, fëmijët filluan të ulërijnë të trembur dhe pasi e lidhën në një karrike i përdhunuan gruan aty në shtëpinë e tij, në sytë e burrit dhe të fëmijëve dhe ai nuk mund të lëvizte...”.

Sado improvizues e spontan që është Bashkim Hoxha gjatë shkrimit, tipar ky që zbulon poetin brenda tij, ai e ka megjithatë të qartë Itakën ku do të mbërrijë dhe nuk hutohet gjatë rrugës, gjë që i jep rrëfimit të tij një qartësi, një dinamikë dhe një ritëm të lartë. Pikërisht rrëfimi i qartë, dinamika dhe ritmi i lartë përshkojnë më pas episodin e Bekimit të turpëruar që nguron ta shohë në sy gruan e tij,

Ajkunën dhe që rrëfëhet nëpërmjet dialogut mes dy personazheve.

“Dashuria është një gjë për t'u kujtuar. Ne kemi një gjë për të harruar. Unë jam e turpëruar.

-Ti nuk je e tupëruar,-i tha ai. - I turpëruar jam unë që nuk të mbrojta dot. Dhe u tretën të dy në një përfaqim. Dukeshin si dy të plagosur që qëndronin në këmbë vetëm sepse mbaheshin te njëri-tjetri...”

Kësisoj, rrëfyer artistikisht “histori romantike që kullojnë gjak”, autori për të qenë sa më i besueshëm për lexuesin, i referohet regjisorit Ben Kaçaniku, i cili thotë se fqinjët e tyre janë patetikë, sepse jetojnë në të shkuarën. Romantizojnë vuajtjen. Shpikin histori.

FRYMA E UNIVERSALITETIT NË ROMANIN E BASHKIM HOXHËS

“Shpëpia e verdhë”, një roman i strukturuar në katër pjesë: Pjesa e parë “Ëndrra” dhe pjesa e dytë “Lufta” me nga shtatë episode secila; Pjesa e tretë që mban titullin e vetë romanit me tetë episode dhe pjesa e katër “Filmi”, me katër episode. Në roman lexuesi do të gjejë lëndën e larmishme, bukurinë e fjalës dhe forcën tërheqëse të leximit. Pavarësisht nga mjediset apo vendi ku zhvillohen ngjarjet, të gjitha episodet janë trajtuar qartësisht, siç ndodh në gjithë krijimtarinë e Bashkim Hoxhës, me frymën e universalitetit. Dukshëm kjo edhe në përfshirjen ndërmjet episodeve të pjesëve të skenarit të filmit, ku autori është vetvetja. Në mjediset e shtëpisë lëvrijnë personazhet: Profesor Vlade, Milena, Azemi, Muhameti, ushtarët hijena.... Evidente kjo, sido-

(Vijon në faqen 14)

IN MEMORIAM

Kopit i janë akorduar disa tituj dhe dekorata të ndryshme dhe Qarku i Korçës e ka shpallur “Nderi i Qarkut”

DHIMBJE PËR HUMBJEN E MIKUT TË RRALLË AKADEMIKUT KOPI KYÇYKU

SHPENDI TOPOLLAJ

Ischim nisur nga Durrësi një grup shokësh për të marrë pjesë dhe për të nderuar post mortem Prof. dr. Nuhi Vincën në Strugë. Rruga më e shkurtër i binte të kalonim nga Qaf Thana, por nuk mund të mos shkonim në Pogradec për të takuar mikun tonë të shtrenjtë, akademikun Kopi Kyçyku. Ca më shumë që në shkëmbimet e e-mail - eve dhe telefonatat që bënim, më pati thënë se kishte qenë ca kohë pa qejf.

Na priti pikërisht tek ajo shtëpia buzë liqenit ku ishte rritur ime shoqe Tatjana dhe unë kisha aq e aq kujtime nga koha e dashurisë. Tani ajo shtëpi karakteristike dykatëshe ishte kthyer nga pronarët në kafene, ku gëlonin klientët e shumtë, ngaqë ishte verë dhe në atë qytet kishte si përherë në këtë stinë pafund pushues.

E pashë me keqardhje se nuk e kishte atë gjallërinë e zakonshme dhe në fytyrë kishte një çehre jo të mirë. Nuk e gjeta me vend ta pyes për diagnozën, por gjithsesi mendova se kjo ishte pasojë e asaj që kishte kaluar dhe se shumë shpejt do ta merrte veten. Këmbënguli të rrinim për drekë, por i thamë se nxitonim për veprimtarinë që na priste në Maqedoninë e Veriut. Pasi bëmë disa fotografi, hipi në makinë me ne dhe kur zbriti tek ai vendi ku banonte të cilin si me shaka na thosh se e quanin “Shurramani”, nuk harroi të na jepte me vete ëmbëlsirat që kishte blerë. Këtë e bënte sa herë na binte rruga andej: e kishte merak të na blinte llokume me arra që sipas tij, askush nuk i bënte më të mira se poradecarët. U ndamë aty për të mos u takuar kurrë më, sido që komunikimet i kishim të paprera. Si gjithmonë, para se t'i botoja artikujt ose krijimet e mia letrare, vazhdoja t'ia dërgoja atij dhe Kopi nuk ngurronte të më jepte gjerë e gjatë përshtypjet e tij.

Më vinte sikur ia merrje kohën apo e lodhja me to, por ai më përgjigjej: “Për ty, i dashur Shpendi, unë le çdo punë sepse kur marr në dorë diçka prej teje, ngazëllem, siç ndodhi edhe tani me Gëten (për të cilin kisha shkruar)”. I jepte shumë rëndësi artikujve publicistikë ku trajtoja çështjen kombëtare, për të cilët jo vetëm më përgëzonte, por edhe më inkurajonte. Më quante atmëmëdhetar dhe kjo bënte që të ndihesha i kënaqur. Kisha arsye të mendoja se shëndeti i tij ishte përmirësuar dhe kjo më gëzonte. Nga ana tjetër, kisha bindjen se një burrë me energjitë e tij, nuk kishte plakje. Aty nga mesi i dhjetorit, u botua libri im me kritika letrare “Ç’do ishim pa letërsinë”, ku në pjesën e pasme të kopertinës vendosa një pjesë nga ajo që Kopi shkruante për mua.

Po ashtu, doli nga shtypi dhe volumi i pestë kushtuar krijimtarisë time, ku analizat e tij zinin një vend të rëndësishëm dhe shtëpia botuese 2M e gjeti të arsyeshme ta çelte me një poezi që Kopi më kishte kushtuar. Natyrisht që ndihesha i vlerësuar dhe i nderuar që me krijimtarinë time merrej seriozisht një mendjendritur si ai. Prandaj i kërkova të më dërgonte adresën që t'ia dërgoja

Kur vinte në Tiranë e nderonte dhe e shoqëronte e gjithë ajka e inteligjencës tonë, dhe krijimtarinë e tij e promovonin në Akademinë e Shkencave... Ka shkruar disa libra, edhe në gjuhë të huaja, si ai për babain e Turqisë Mustafa Qemal Atatürkun apo Atatürkun e kohës tonë Hajdar Alievin, Jeta e Mihai Emineskut, marrëdhëniet shqiptaro - rumune, arumunët e Shqipërisë etj.



ato libra, se “Shurramani” nuk kishte kuptim. E pashë se mezi i dilte fjala nga goja dhe më tha të mos nxitohem, pasi së shpejti do të nisej për Rumani. Unë, fatmirësisht nxitova dhe falë të vetmit shërbim shembullor që kemi, postës, pakua me librat e mi i shkoi. Më uroj e falenderoj dhe më tha se pasnesër nisem. Tek ai më rrinte mendja, se e kisha një parandjenjë se diçka nuk shkonte. Dhe kjo nuk zgjati shumë; shkrimtari mjaft i njohur Fatmir Terziu që nga Anglia ku jeton e punon, jepte kumtin se u shua akademiku Kopi Kyçyku. Nuk kishte prituri edhe nja dy ditë sa të vinte Viti i Ri 2025. Edhe pse u trondita pa masë, përsëri nuk u besova syve, pasi diçka së brendshmi më thosh se ndofta nuk është e vërtetë, se jepen dhe lajme të rreme dhe mundet të këtë gabuar Fatmiri. Por jo: vullkani Kopi Kyçyku, eruditi dhe poliglotti, prozatori dhe përkthyesi, madhështori dhe i thjeshti ishte shuar vërtetë. Ndënja gjithë ditën duke vërtitur televizorin, por aha, asnjë stacion, nuk dha ndonjë njoftim për këtë humbje të madhe për kombin mbarë. As gazetatat nuk denjuan të shkruanin për të. Askush nuk mori mundimin të botonte edhe artikullin që unë i kushtova atij, ku me bindje thosha se populli i Pogradecit i detyrohet Kopi Kyçykut që t'i ngrëjë një monument bronzi krahas atij të Lasgushit e Mitrushit atje buzë atij liqerit të tij të dashur, nga i cili nuk i ndahej shpirti. Iku një njeri i shquar nga kjo jetë, sikur të mos kishte qenë fare. Në Shqipëri mesa duket kishte lajme më të rëndësishme...

Kopi Kyçyku, inxhinieri, pushtetari, deputeti, gazetari, shkrimtari i shquar tani do të mbetet në kujtesën e të gjithë atyre që e njohën, burri tek i cili si te

rrallëkush bashkohej dituria superore me thjeshtësinë e pabesueshme.

Kur vinte në Tiranë e nderonte dhe e shoqëronte e gjithë ajka e inteligjencës tonë, dhe krijimtarinë e tij e promovonin në Akademinë e Shkencave, ku diskutonin njerëz nga më të mençurit, kurse në Pogradec, çdo ditë shoqërohej dhe e pinte kafënë me njerëzit e zakonshëm, deri dhe nga ata të profesioneve më të rëndomta.

Sa herë hapja FB ishte e pamundur që në profilin e tij të mos gjeje një skicë ose poezi kushtuar atyre, le pastaj kur ndonjëri ndërronte jetë.

Te kushdo do të gjente diçka që e vliente të evidentohet, se fundja njeriun nuk e bëjnë të shquar vetëm titujt që mban a detyrat e mëdha që kryen. Kur e merrja në telefon, më thosh gjithmonë: Foli këtë mikut që kam në tavolinë, o dhëndër i Pogradecit. Nuk mbahej më të madh Kopi Kyçyku dhe kjo e bënte akoma madhështor në sytë e mi. Ai, bukurinë e jetës e shihte së pari te njerëzit. Por emrin e Kopit, kam pasur shpesh herë rastin ta dëgjoj që ta përmendin me shumë dashuri edhe në Kosovë e Maqedoni të Veriut. Ai, ishte i njohur në ato vende, se sa herë shkonte, me elokuencën, passionin dhe llogjikën e tij i ndizte flakë zemrat e dëgjuesve, me dashurinë për Kombin tonë. Me këtë elokuencë, passion e llogjikë dalloheshin edhe ligjeratat që mbante edhe në konferencat e ndryshme anë e kënd Evropës, deri në Azi e Afrikë ku ishte i ftuar. Ishte kjo arsyeja, pse ai lidhte miqësi të sinqertë me personalitete të kulturës tonë dhe veprimtarë të shquar në diasporë, për çka flasin edhe librat monografikë të shkruar prej tij, si ai kushtuar figu-

rave të njohura atdhetare si Astrit Leka apo Besim Sahatçiu, gjyshi i këngëtares me famë botërore, Rita Orës. Me analizat e tij të thelluara për historinë apo kulturën shqiptare, jo vetëm që bëri plot miq e simpatizantë nga bota shkencore, por edhe i dhanë mundësinë të nderohet duke u zgjedhur anëtar i disa Akademive me emër. Po ashtu, një kontribut i madh i tij ishte dhe themelimi dhe botimi në vazhdimësi i revistës HAEMUS atje në Bukuresht, ku jeton dhe punon djali i tij, shkrimtari Prof. dr. Ardian Kristian Kyçyku, dhe “Thë Eastern European Mesenger” Londër.

Ka shkruar disa libra, edhe në gjuhë të huaja, si ai për babain e Turqisë Mustafa Qemal Atatürkun apo Atatürkun e kohës tonë Hajdar Alievin, Jeta e Mihai Emineskut, marrëdhëniet shqiptaro - rumune, arumunët e Shqipërisë etj.

Kopit i janë akorduar disa tituj dhe dekorata të ndryshme dhe Qarku i Korçës e ka shpallur “Nderi i Qarkut”. Vitet e fundit, duket se ishte velur nga lavdia, dhe jo vetëm që nuk e kërkonte, por më bëhej sikur i largohej asaj. Sikur ishte bërë epikurian dhe nuk donte të dukej. Nuk kishte fushë të dijeve njerëzore dhe kulturës që të mos fliste me kompetencë, dhe gjithmonë jo me fjalë të mëdha e të zgjedhura, për të bërë efekt, por thjeshtë, fare thjeshtë, sikurse edhe shkruante. Ashtu siç shprehej edhe Çehovi se “te thjeshtësia qëndron talenti”. Fliste me zë të lartë, shoqëruar me gjeste, qeshte me gjithë shpirt dhe dinte të bënte shaka. Kopi ishte i drejtëpërdrejtë dhe nuk ngurronte të bënte vrejte, madje edhe kur dikush gabonte në përdorimin e ndonjë fjale, ai krejt sinqerisht dhe pa fyer askënd e korrigjonte, duke i thënë se do të flasësh edhe me të tjerët dhe duhet të jesh i saktë. Në gjithë përditshmërinë e tij si edhe në krijimtarinë, binte menjëherë në sy, skrupuloziteti i tij për pastërtinë e gjuhës shqipe. Ja sesi më shkruante në një rast pasi kishte lexuar një novelën time: “Një superperle! Të lutem Xhezuin përdore gjithmonë me Xh, jo me Zh”. Ose: “Diçka teknike: të lutem përdor kryeradhën, e cila mungon dhe e bën leximin të mundimshëm”. Ah! Kopi Kyçyku! Zemra jote pushoi së rrahuri në moshën e Gëtes që e përmenda pak më sipër, ndaj lejome të të drejtohem me fjalët që kam shkruar për të, por që i meriton edhe ti: “Kur rasti e solli që në vitin 1808... të takohej me Napoleon Bonapartin, ky iu drejtua të pranishmëve, duke u thënë afërsisht: “Ja njeriu! Ju jeni burrë zoti Gëtel!” Dhe i tillë që ai që gjithë jetën këshillonte: “E ardhmja i takon vetëm atij që harron urrejtjen dhe mbjell dashurinë”, ai, porrosia e mençur e të cilit edhe mua nuk më u nda asnjëherë dhe për të cilin me të drejtë u tha se ishte “njeriu i fundit në botë që di çdo gjë”.

80 VJET MË PARË

Lufta Antifashiste, një ndër epokat më të ndritura në historinë e Shqipërisë

Marshimi heroik i tre batalioneve të Brigadës së Parë Sulmuese

Në një kohë kur Operacioni i Madh i Dimrit 1943-1944 nuk kishte mbaruar akoma dhe për çudi, okupatorët nazistë gjermanë kishin deklaruar bashkë me kolaboracionistët, se Ushtria Aantifashiste Nacional Çlirimtare dhe lëvizja popullore që mbështeste këtë luftë kishin mbaruar, i gjeti këta të parët në befasi dhe të alarmuar. Ndërsa popullit i dha zemër dhe besim tek forcat partizane për një çlirim të plotë nga okupatori. Marshimi luftarak nga Shqipëria e Jugut për në Shqipërinë e Mesme të tre batalioneve të Brigadës së I-rë Sulmuese u vendos nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Aantifashiste Nacional Çlirimtare. Ky marshim u drejtua nga komandanti i Brigadës, Mehmet Shehu dhe u krye në kushte të vështira, në një dimër shumë të ashpër. Ata duhet të kalonin nëpër male të larta të mbuluara me dëborë, të veshur jo mirë dhe deri diku pa ushqime. Qëllimi ishte që forcat partizane, me një eksperience luftime më të mirë dhe luftëtarë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë t'i çorientonin nazifashistët gjermanë e kolaboracionistët dhe të lehtësonin veprimet luftarake të qarkut të Elbasanit që manovronin në krahinat e Çermenikës, Shëngjergj e Martanesh dhe t'u vinin në ndihmë një pjese të Shtabit të Përgjithshëm. Me 21 shkurt 1944 forcat e Brigadës, pas luftimesh që kishin zhvilluar në Skrapar, u nisën nga Kapinova, kaluan në Qafë Dardhë, Opar, Gorë dhe më 25 shkurt arritën në Çezmë të Mokrës (Malësi e Pogradecit). Sipas urdhrit të Komandantit të Brigadës, batalionet duhet të lëviznin të organizuara dhe me shpejtësi në mënyrë që të arrinin sa më parë dhe pa u zbuluar nga armiku në zemër të Çermenikës. Marshimi do bëhej drejt Qukës - Qarrishtës dhe Çermenikë - Shëngjergjit.

Me 26 shkurt të tre batalionet, nga Çezma e Mokrës, vazhduan marshimin e tyre të lavdishëm duke kryer luftimin në marshim për të thyer pritat që armi-



ku iu kishte përgatitur tre batalioneve, me synimin që t'i asgjësonte. Pikërisht duke pasur informacion, nazistët goditën forcat e Brigadës në një terren shumë të vështirë në fshatin Skroskë afër Qukësit. Në këto luftime ndeshës, partizanët patën humbjesi të mëdha. Në vazhdim të marshimit forcat partizane treguan trimëri të rrallë. Duhej që patjetër të arrihej objektivi. Prita ishte në kodër të mbuluar me dëborë. Veç pozicionimit të favorshëm për armikun, aty mund të vinin dhe forca të tjera armike nga Librazhdi. Pas luftimesh të ashpra që bëri Batalioni i I-rë me armikun, forcave kryesore të Brigadës iu krijua mundësia të vazhdonin marshimin. Urdhri ishte që forcat kryesore të mbështetnin njëra - tjetrën duke i dhënë mundësi forcave të batalionit të parë të bashkoheshin me ta. Partizanët e Brigadës I zhvilluan luftime me forcat që kishin ardhur nga Librazhdi në fshatrat Velçan e Peshkur. Kundërgoditja e forcave të Brigadës i detyroi forcat armike gjermane të tërhiqeshin në bazën e nisjes mbi rrugën Librazhd-Qukës.

Pas këtyre përpjekjeve, Komandanti i Brigadës u tregoi partizanëve për misionin që u ishte ngarkuar tre batalioneve dhe kërkoi mendim rreth vendimit që uishte ngarkuar, për të vazhduar ose jo marshimin. Përgjigja ishte një e vetme: "Të gjithë, të gjithë do të shkojnë. Rroftë Shtabi i Përgjithshëm!". Ata shkuan përpara me guxim dhe vetëmohim e iu ngjiten përpjete malit të Shebenikut dhe më 28 shkurt arritën në kasollet e Dragoshtunit. Këtu pasi pushuan disa orë, ashtu siç ishin të pa ngrënë e pa gjumë, që nga data 26 shkurt, ata çanë rrugën në drejtim të Qarrishtës. Gjermanët nazistë nuk hiqnin dorë nga shpartallimi i këtij marshimi të kësaj force ushtarake, e cila u hapi shumë punë në Shqipërinë e Mesme që ishte plotësisht nën diktatin e armikut. Më 29 shkurt, 600 forca gjermano-naziste e kolaboracionistësh që i mbështesnin, goditën forcat partizane të Brigadës në Qarrishtë, ndërsa forcat armike të ardhura nga Librazhdi kishin zënë prita në të gjitha grykat në Lunik dhe donin t'u prisnin rrugën. Por ata luftuan me trimëri dhe heroizëm duke i shkak-

tuar armikut dëme të mëdha në njerëz, armatim dhe materiale të tjera. Ndërsa forcat partizane patën humbje të pakta, kaluan malin e Lëmit dhe zbritën me shpejtësi në rrugën Librazhd-Dibër dhe zunë katundin Llangë para se ta zinte armiku. Më pas vazhduan marshimin në drejtimin Llangë -Zabzun, Okshtun e Kaptina e Martaneshit - Guri i Bardhë. Në tërësi të gjitha përpjekjet e armikut për të shpartalluar forcat e Brigadës dështuan. Pasi detyra e ngarkuar u arrit me një manovër të shkëlqyer, forcat partizane kryelartë se kryen një detyrë shumë të vështirë, kaluan në Qarkun e Tiranës e konkretisht në Pezën heroike. Nga Peza forcat e Brigadës I Sulmuese përshkajnë krahinën e Pezës dhe kalojnë lumin Shkumbin, arrijnë në Dumre ku zunë robër 170 xhandarë dhe, më 20 mars arritën në Sulovë. Fill mbas një muaji bashkohen me forcat e tjera të Brigadës I Sulmuese. Ky marshim i tre batalioneve shkaktoi habi dhe panik në forcat e armikut dhe kolaboracionistëve. Për çudinë e marshimit të partizanëve, jepeshin informacione të pabesueshme nga ana armike: p.sh. se Mehmet Shehu me 500 veta ka hyrë në fshatin Rasë të Elbasanit. Po të njëjta informacione vinin nga Peqini e Berati, se Brigada I Sulmuese bashkë me forcat partizane të Pezës do sulmojnë Kavajën, Peqinin dhe si ka mundësi që ata të kalonin dhe lumin Shkumbin kur ai ishte i pakalueshëm. Për këtë veprim ushtarak të shkëlqyer të kryer nga tre batalionet e Brigadës së I-rë Sulmuese dhe që bëri një jehonë të madhe në të gjithë vendin, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Aantifashiste Nacional Çlirimtare i përgëzoi dhe ju dha fletë-lavdërimi në të cilën midis të tjerash thuhet: "Shtabi i Përgjithshëm nënvizon kujdesin e veçantë të komandës, e cila tok me batalionet I, II dhe III të Brigadës I Sulmuese, pa marrë parasysh as lodhjen e as pengesat që mund të hasnin gjatë rrugës, por të bindur dhe të disiplinuar siç u ka hije partizanëve, të shtyrë nga dashuria e madhe për Atdheun, popullin dhe shtabin e Përgjithshëm, kanë vepruar për një pjesë të Komandës së Shtabit të Përgjithshëm, që ndodhej në zonat e rrezikshme dhe të përshkuara nga gjermanët e kolaboracionistët".

(- Marrë nga arkivi i historisë ushtarake - Sipa kujtimeve të kolonel Myfit Guxhillit - ish kuadër i brig.IV, -Nënkryetar dhe kryetar i OBVLP)

81 vjetori - Brigada e Pestë, histori suksesesh të njëpasnjëshme

(Vijon nga faqja 2)

sa më gjerë të tij në Luftën Antifashiste, duke patur të drejtën të kërkojë zbatimin e vendimeve të Konferencës së Bujanit për vetëvendosje. Me trimëri e sjellje shembullore partizanët e Brigadës së Pestë fituan dashurinë e admirimin e popullit kosovar; shumë të rinj kosovarë hyjnë vullnetarisht në radhët e Brigadës duke e dyfishuar efektivin e saj dhe ata luftuan me trimëri në Sanxhak.

Mbas luftimeve në Kosovë, Brigada e Pestë S bashkë me atë të Tretë dhe 25- të u inkuadruan në Divizionin e V-të që pata nderin ta komandoj në luftimet në tokat e ish - Jugosllavisë. Sa u gëzova që pas një periudhe 7 mujore do isha bashkë me shokët e mi e do të ndanim së bashku vuajtjet dhe sakrificat që kërkon lufta; hidhërimet kur të vriten shokët, po dhe gëzimet që të jep fitorja. Shumë nga shokët kishin rënë heroikisht duke luftuar, mjaftë të tjerë ishin ngritur në përgjegjësi dhe kishin shkruar me detyra në reparte të tjera, por shumicën i kisha aty e për mua ishte kënaqësi.

Brigada në Sanxhak vepronte në kondita shumë të vështira, luftohej në terren krejt malor në një dimër shumë të ashpër, në një tokë të shkretuar nga gjermanët. Ishte lluks kur sigurohej patatja për të ngopur

barkun. Nga ana tjetër gjermanët kishin ndërtuar një mbrojtje pozicionale dhe që mbroheshin me këmbëngulje për të siguruar rrugët e tërheqjes nga Mali i Zi, gjatë luginës së lumit Lini dhe në Veri për të siguruar tërheqjen e trupave nëpërmjet nyjes hekurudhore tepër të rëndësishme të Vishegradit.

Luftimet e zhvilluara për afro dy muaj në Sanxhak kanë qenë të ashpra dhe na është dashur të parballojmë vështirësi të mëdha. Veçanërisht të vështira qenë luftimet për marrjen e nyjeve të fortifikuara të Jadovnikut, Bitovikut, Mileshevdolit etj, duke çliruar bashkë me forcat e tjera të Divizionit të V-të qytetet Sjenu, Pripolje, Priboj etj. Po edhe në këto luftime efektiv i Brigadës korri fitore duke treguar edhe njëherë trimëri e vendosmëri të admirueshme.

Gjaku i derdhur në Sanxhak ishte kontributi që jepte ushtria jonë në kuadrin e luftës antifashiste botërore; jo vetëm në çlirimin e popujve të ish Jugosllavisë, por edhe në fitoren e bllokut antifashist ndaj fuqive fashiste, mbasi angazhimi i forcave gjermane në luftime me divizionet tona nuk e lejoi komandën gjermane ta përdorte armatën e saj kundër frontit të dytë.

Gjatë rrugës së saj luftarake brigada ka zhvilluar shumë beteja ushtarake, ajo ka korrur fitore të lavdishme, por edhe humbjet kanë qenë të ndjeshme. Nga radhët e luftëtarëve të saj kanë dhënë jetën 350

dëshmorë e qindra të tjerë janë plagosur e gjymtuar. Në mes dëshmorëve janë heronjtë dhe heronjtë e heronjat: Abaz Shehu, Dervish Hekali, Kastriot Muço, Zaho Koka, Zonja Çurre, Laze Nuro, Llambro Andoni, Hysen Çino e Nimete Progonati. Është detyra jonë që traditat luftarake të Brigadës së Pestë heroike t'ua transmetojmë brezave të ardhshëm, se ato bëjnë pjesë në thesarin brilant të traditave shekullore të të parëve tanë.

Kjo edhe për faktin se moshë mesatare e efektivit të Brigadës së Pestë ka qenë lule e rinisë nga 15-22 vjeç. Ata luftuan e ranë për një ideal të lartë, për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, për lirinë e popullit të tyre, për një Shqipëri demokratike, me ato ideale që përcakttoi konferenca e Pezës. Po fatkeqësisht në luftëtarët jemi zhgënjyer, se diktatura enveriane nuk u qëndroi besnike idealave për të cilat luftuam e për të cilat ranë shokët tanë. Sepse ajo e katandisi vendin tonë në më të varfërin e Europës. Detyra jonë sot është të mbështesim proceset demokratike, konsolidimin e shtetit ligjor e forcimin e rendit juridik që lidhen drejtpërsëdrejti me integrimin e Shqipërisë në Europë. Për ne mbi gjithçka janë interesat e Atdheut e të Kombit.

*Ish komandant i Divizionit të V-të - Marre nga libri "Një shekull në memorie"

HOMAZH

Ishte shoqërues e këshilltar i gjeneral leitnant Rahman Parllakut – “Hero i Popullit” dhe “Nderi i Kombit”

UKË CENA, ushtaraku dhe juristi shembullor që s’do harrohet kurrë

• **Për punë me profesionalizëm të lartë dhe plot përkushtim mbante medaljen e “Shërbimit Ushtarak”, Urdhrin “Ylli i Kuq” të klasit III, Urdhrin “Skënderbeu” të klasit II dhe urdhrin “Për shumë vite në ushtri”**

Dy muaj më parë, (22 Nentor 2024) pas një sëmundje të rëndë u nda nga jeta avokat UK JAKUP CENA, anëtar i Këshillit Drejtues Kombëtar të OBVL, duke lënë në pikëllim djemtë Arjanin e Dritanin bashkë me familjet e tyre, vëllezërit Agim e Melaim Cena, motrat, nipat e mbesat dhe ne, njerëzve të gjakut të tij si dhe miqtë e shokët e shumtë në gjithë vendin.

Ai ishte dhe mbeti i thjeshtë, duke banuar në një apartament modest bashkë me djemtë e tij.

Djali i Kalisit nuk e harroi kurrë vendlindjen, dera e tij ka qenë gjithnjë e hapur për bashkëkoharët e tij dhe i perkushtuar për t’ju zgjidhur hallet e problemet, që u dilnin në jetë. - shkruan z. Rexhep Xhepa- ish oficer i lartë i ushtrisë shqiptare, djali i dajës së Ukës, në njoftimin mortor të ndarjes nga jeta të kolonelit, gjyqtarit e avokatit Uke Cena.

Ukë CENA u lind në Kalis, më 28 mars 1940.

Shkollën 7-vjeçare e kreu në vendlindjen e tij, në Kalis.

Shërbimin ushtarak e kreu në Marinë dhe prej këtu fitoi të drejtën e vazhdim të studimeve ushtarake dhe të rreshtimit në radhët e ushtrisë si ushtarak efektiv.

Kështu, ai kreu me rezultate shumë



të mira shkollën ushtarake “Skënderbeu”, në Tiranë. Pastaj, vazhdoi dhe përfundoi shkollën ushtarake të Marinës Detare në Durrës dhe në vitin 1961, u titullua oficer karriere.

Ka një karrierë të gjatë dhe brilante në radhët e ushtrisë. E nisi si shef i Shifrës së Dragaminës së Madhe në ishullin e Sazanit, në Vlorë.

Në vitet 1961-1963, mbajti gradën e nëntogerit, ndërsa në vitet 1963-1967, ka kryer detyrën e shefit të postave sinjalovrojtuese (PSV) në Sillo, të Shëng-

jinit dhe mbajti gradën e kapitenit.

Në vitet 1967-1974, ishte shoqërues e këshilltar i gjeneral leitnant Rahman Parllakut – “Hero i Popullit” dhe “Nderi i Kombit”. Gjatë kësaj periudhe kreu studimet e larta në Fakultetin Juridik, si dhe shkollën e Lartë të Partisë.

Pasi kreu dhe këto studime, ka kryer detyrën e sekretarit të Partisë në brigadën e Grykë-Manatisë, Lezhë. Pastaj, ishte komisar i batalionit të këmbësorisë me ushtarë efektiv në Vorë, si dhe ishte i zgjedhur dhe zv. sekretar i Partisë së brigadës së këmbësorisë së Laçit.

Në vitin 1982, ka kryer detyrën e komisarit të Korpusit të 4-të, me efektiv ushtarë të fortifikimit në aksionin e rinisë ushtarake, për hapjen në gatishmërisë të objekteve fortifikuese (qendra zjarri, PZA, PDO, PD, si dhe transhe e hendeklidhje).

Pas këtij aksioni, u emërua shef edukimi në brigadën e këmbësorisë, Selitë, ku dhe mbylli karrierën ushtarake.

Për punë me profesionalizëm të lartë dhe plot përkushtim mbante medaljen e “Shërbimit Ushtarak”, urdhrin “Ylli i Kuq” të klasit III, urdhrin “Skënderbeu” të klasit II dhe urdhrin “Për shumë vite në ushtri”.

Pas lirim nga ushtria ka punuar si jurist, gjyqtar në gjykatën e rrethit gjyqësor të Tiranë (1993-1996) ku ka

kryer edhe detyrën e zëvendëskryetarit të kësaj gjykate.

Në vitin 1992, ka marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues në gjyqin kundër Nexhmie Hoxhës dhe bllokmenëve të tjerë.

Ka qenë anëtar i shoqatës së Historianëve Ushtarakë të Shqipërisë me kryetar Shahin Lekën dhe Gjergj Titanin. Ka marrë pjesë në kongreset e zhvilluar për Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore në Holandë, Suedi, Belgjikë, Bullgari dhe Greqi.

Nga viti 1997, ishte kolonel në rezervë.

Ishte anëtar i Dhomës së Avokatisë së Tiranës dhe ushtronte profesionin e avokatit.

Ky burrë i madh, me vlera të jashtëzakonshme qytetare e profesionale, pas 31 vitesh si ushtarak karriere dhe 22 viteve si jurist, gëzoi respektin e admirimin e jashtëzakonshëm të kolegëve, të njohurve dhe të fisit e farefisit. Por, u largua prej nesh ky burrë fisnik, ky burrë i mençur, duke lënë një boshllëk në komunitetin e vet, që vështirë se mbyllet shpejt.

Ishte besimtar, besonte tek e mira, tek virtyti e bamirësia, besonte edhe në Zot

OBVLP i shpreh ngushëllime familjes, fisit, farefisit, miqve, shokëve dhe kolegëve!

Parajsa qoftë vendbanimi i tij i përjetshëm!

Akademik FATOS DACI
Mjeshtër i Madh

Në gjurmët e babait që ishte ndër themeluesit e OBVL, edhe Dashnori që një na pasardhësit më të denjë të organizatës tonë

LAMTUMIRË DASHNOR SYRJA ZEQRILLARI

Krenar për babain e tij Syrja Tahirin, një personalitet i nderuar e i respektuar në Përmet dhe në gjithë Shqipërinë, si ish partizan trim, pjesëmarrës aktiv që në formimin e çetës partizane “Musa Fratari” e në batalionin “Naim Frashëri” të Brigadës së VI-të Sulmuese, dhe pas çlirimit kuadër i devotshëm e vizionar në Dibër e Përmet, Dashi do të trashëgonte, mishëronte e përçonte ndër breza mençurinë, urtësinë e largpamësinë e tij

Më 14 janar 2025, familjarët, miqtë, shokët dhe të afërmit i dhanë lamtumirën e fundit Dashnor Syrja Zeqirllari. Ai lindi më 24 Tetor 1948 në Peshkopi. Arsimin bazë e kreu në shkollën 8 vjeçare Këlcyre, për të vijuar më pas mësimet në Shkollën e Mesme Pedagogjike Gjirokastrë, ku u diplomua me rezultate të shkëlqyera.

Dashnori realizoi kështu ëndrrën e babet të tij, Syrjajit për t’u bërë i aftë që të përhapte dritën e diturisë në vendlindjen e tij.

Pas mbarimit të pedagogjikes punoi për dy vjet si mësues në rrethin e Përmetit. Por kurrësi ai nuk mund të mjaftohej vetëm me këtë nivel arsimor.

I bindur se vetëm duke studiuar do të mund të ecte me kohën, vazhdoi përsëri studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër, për histori-gjeografi dhe fiskulturë. Tashmë me formimin e duhur rikthehet mësues në gjimnazin e Këlcyrës, kur kishte fituar përvojë në pedagogji e mësimdhënie. Kishte kryer arsimin e duhur, ndaj dhe vjen gjithë gëzim si mësues në Shkollën e Mesme të Përgjithshme të Këlcyrës.



Ishte koha, kur po kontribuonte për arsimimin e fëmijëve të bashkëqytetarëve të tij, ndaj dhe e udhëhiqte për veprim zëri i brendshëm i ndërgjegjes. Përvojën e tij të pasur ua përcillte kolegëve, duke u bërë kështu mësues i mësuesve.

Në misionin fisnik të mësuesit, në shkollat e vendlindjes së tij, Dashnor Tahiri ishte dhe mbetet një figurë e dashur për mijëra nxënësit e prindërit e tyre, si dhe për dhjetëra kolegët, që e merrnin si shembullin pozitiv të mësimdhënies. Kreu me devotshmëri e përkushtim edhe shërbimin ushtarak në Tiranë dhe më pas ka punuar në hidrogeologji po

në Tiranë.

I edukuar me virtytet më të mira të familjes së tij dhe nën shembullin e saj, Dashi krijoi edhe vetë një familje shembullore me bashkëshorten Shyqyrien në qytetin e Beratit, ku lindën, mirëritën dhe edukuan dy djemtë, Armandon dhe Emiljanon (të dy aktualisht të martuar dhe banues në Tiranë).

Dashnori ishte bashkëshort e prind shembullor, një gjysh i dashur dhe i përkushtuar i tre nipërve, si dhe vëlla i dhëmbshur e mbështetës i pakursyer për motrat Natashën, Selinën, Ruzen dhe vëllezërit: Ilirin, Kimin dhe Agronin.

Krenar për babain e tij Syrja Tahirin, një personalitet i nderuar e i respektuar në Përmet dhe në gjithë Shqipërinë, si ish partizan trim, pjesëmarrës aktiv që në formimin e çetës partizane “Musa Fratari” e në batalionin “Naim Frashëri” të Brigadës së VI-të Sulmuese, dhe pas çlirimit kuadër i devotshëm e vizionar në Dibër e Përmet, Dashi do të trashëgonte, mishëronte e përçonte ndër breza mençurinë, urtësinë e largpamësinë e tij. Në gjurmët e babait që ishte ndër themeluesit e OBVL, edhe Dashnori që një na pasardhësit më të denjë të organizatës tonë.

I tillë do të kujtohet Dashi, nga familjarët, të afërmit, miqtë e shokët e shumtë, nga veteranët dhe pasardhësit, anëtarë të OBVL, që nderohej e respektohej prej tyre.

I përjetshëm kujtimi i tij....
KRYESIA e OBVL

HOMAZH

Sefer Koçi - Një veteran në Parajsë

Faik Xhani, Sakip Sula

Në funksionin e ushtarakut rezervë ai do të ishte në detyra deri në Komisar Batalioni dhe u përpoq të bënte më të mirën e vet, u shqua për realizim të detyrave, shpirt sacrifice e sidomos në ruajtjen e unitetit në njësitë ku drejtoi

Veterani Sefer Koçi nga Okshtuni i Dibrës, me banim në Balldre të Lezhës u nda nga jeta në mënyrë të beftë më 17 tetor 2024.

Seferi lindi në Prodan të Okshtunit më 5 gusht të vitit 1937 në familjen e madhe të Ferhat Selmanit (Koçi) dhe ishte djali I parë i mësuesit të mirënjohur në Diber, Lezhe e më gjërë, Selman Koçi.

Fëmijëria e tij kaloi përmes viteve të stuhishme të luftës së dytë botërore dhe asaj të lavdishme nacional çlirimtare që kreu me heroizëm populli shqiptar. Ai u rrit duke parë e ndjekur me kureshtjen e një fëmije kollonat e gjata partizane që kalonin asaj ane dhe miqtë e shumë partizanë me kapelen me yll në ballë e armë në sup. Pati rastin të ulej në prehrin e figurave historike si Haxhi Lleshi, Baba Faja etj. dhe të luante me armët e tyre në oden e miqëve ku jo rrallë qenë ulur 50-60 burra dhe ëndrrën që të rritej dhe të bëhej edhe ai një luftëtar për atdheun e vet. U përfshi në detyrat që i lejonte moshën dhe kreu me besnikëri rolin e korierit në lagje, në fshat e më gjërë. Ishte koha kur në Prodan do të strehohej Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë nacional çlirimtare dhe misioni anglez, do të qëndronte rreth 6 muaj shkrimtari dhe luftëtar i orëve të para, Haki Stërmilli, do të kalonte e strehohej Brigada e parë sulmuese, kur çeta e Martaneshit dhe ajo e Dibrës e Gollobordës do ta kishin Okshtunin si shtëpinë e tyre dhe dera e Ferhat Selmanit do të ishte gjithmonë e hapur për ta. Kur shtabi i përgjithshëm dhe misioni anglez qëndronin në shtëpinë e Imer Koçit, një kushëri i afërt i Ferhatit (gjyshi i Seferit), ai me kushërinj të tjerë do të ishte ndërldhësi më i shpeshtë i dy familjeve, pasi gruaja e Imerit, Qamilja, ishte motra e vogël e asaj të Ferhatit (ishin vajzat e Sul Dalipit nga Kostenja, të martuara të dyja te fisin Koçi në Prodan) dhe për cdo nevojë do të drejtohej para të gjithëve motrës së madhe Fatimes (gjyshja e Seferit).

Me një herë pas çlirimit të vendit u përfshi në reformat e mëdha të kohës. U regjistrua në shkollë dhe mësonte shumë mirë. Gjithmonë tregonte me krenari se në vitin 1947 erdhi nga Elbasani e kaloi atyre anëve inspektor i Ministrisë së arsimit, normalisti Mehmet Çadri, i cili pasi kontrollon nxënësit për njohuritë që kishin, atë e kaloi nga klasa e dytë në atë të katërt. Një vit më vonë ai do të ishte mësues dhe u përfshi në luftën kundër analfabetizimit. Thuajse fëmijë ai do të mësonte moshat e rritura deri edhe të moshuarit që mësonin shkrim e këndim nëpër shtëpitë e fshatarëve si Zyber Koçi e Tahir Stojku. Ai u rrit e u formua në shkollën e jetës dhe mësuesit e tij të parë ishin Imer Koci, njeri shumë i afërt i fisit dhe baxhanak me Ferhatin, Jonuz Jeshari, Tahir Rexha, Sehiti e Ahmet Lika, Hajdar Stojku, por sidomos ata të familjes si Ferhati e Selmani dhe Selimi, Reshiti e Zyberi e të moshuarit e tjerë të rrethit familjar. U rrit e u formua me cilësitë e mira të njeriut punëtor, trim e të ndershëm, mikpritës e patriot që e don pa kufi famil-



jen dhe atdheun e vet. Mori pjesë aktive në aksionet e reformat për rindërtimin e vendit thuajse që fëmijë dhe gjatë gjithë jetës së tij. Gjatë viteve 1951-1959 ai ishte me gjysh Ferhatin dhe shtegtonte në Mat e zona të tjera dhe shërbente si bari e mësoi në nivel shumë të mirë mjeshtrinë e muratorit, ku përvetësoi mjeshtërisht artin e punimit të gurit e drurit dhe u bë një specialist shumë i aftë në këtë fushë.

Në vitet 1959-1962 kreu shërbimin ushtarak në fillim në Vlore dhe pastaj në Rinas dhe në Burrel ku drejtonte një togë që u muar me ndërtime e kreu vepra cilësore ushtarake. Pas lirimt nga ushtria kthehet në fshat dhe zgjidhet sekertar e kryetar i Kshillit popullor dhe më 1966 me krijimin e Kooperativës bujqësore ishte llogaritar i saj. I martuar e me tre fëmijë ai shkoi për të studjuar në shkollën ekonomike të Beratit të cilën e kreu me rezultate shumë të mira në vitin 1970.

Pas bashkimit të katër kooperativave bujqësore me qendër në Okshtun, Seferi do shëf i llogarisë në Kooperativën e bashkuar dhe shumë vite ishte Sekretar i byrosë së Partisë në një zonë me aq shumë probleme të karakterit ekonomik dhe çështje sociale të ndërlikuara. Ai e mbajti me dinjitet peshën e këtyre detyrës dhe u përpoq që të zbatonte ligjet e direktivat në mënyrën më elastike dhe humane të mundëshme duke qenë e mbetur në krahun e njerëzve të thjeshtë e hallexinj. U përpoq që të mos i mungonte buka e ushqimi askujt edhe për ata që ishin të pa mnudur që të punonin, që të shkolloheshin mundësisht të gjithë fëmijët që kishin prirje e vullnet për

këtë detyrë. Bëri një punë të pa lodhur e shembullore për ruajtjen e unitetit të popullit, parandaloi grindje, mëri e mosmarveshtje dhe ishte kundër divorceve të kota e për arsye banale. Mbahet mend si një kuadër komunikues e luajal, që e deshën dhe e respektuan të gjithë dhe ishte derë e kapur për cdo individ e familje që kishte nevojë për ndihmën e tij.

Pas vitit 1976 ai u transferua në rrethin e Lezhës, u vendos në Balldre të këtij rrethi ku kreu detyrën e ekonomistit në Ndermarjen bujqësore. Punoi si ekonomist dhe kreu detyra shoqërore Partie e në Organizatën e Frontit dhe mbajti gjithnjë ndezur luftën kundër zënkave e mërive e punoi për unitetin në familje e në popull.

Sefer Koçi ishte atdhetar dhe e deshi Okshtunin dhe Dibrën, më pas edhe Lezhën ku kaloi vitet e fundit të jetës. Bëri një shkollë ushtarake dhe fitoi njohuritë e statusin e një oficeri të përgatitur. Në funksionin e ushtarakut rezervë ai do të ishte në detyra deri në Komisar Batalioni dhe u përpoq të bënte më të mirën e vet, u shqua për realizim të detyrave, shpirt sacrifice e sidomos në ruajtjen e unitetit në njësitë ku drejtoi.

Seferi ishte besimtar, besonte tek e mira, tek virtyti e bamirësia, besonte edhe në Zot. Ai shkoi në Haxh dhe kryente me devotshmëri ritet fetare pa ju imponuar askujt në idetë dhe mendimin e vet.

Sefer Koçi ishte familjar, po një familjar shembullor. Ai u kujdes me gjithë përkushtimin e nevojshëm për pleqërimin e gjyshërve e prindëve. Si vëllai më i madh i një familje me shumë fëmijë ai u kujdes për rritjen dhe edukimin e shkollimin e vëllezërve e të motrave, 6 prej të cilëve u shkolluan me sukses dhe 3 bënë arsimin e lartë me gjithë vështirësitë ekonomike e ato të terrenit të një zone malore në skaj të Dibrës. Ai u martua me Tushen dhe pati pesë fëmijë, tre djem e dy vajza: Fatmirin, Arbenin, Dashamirin dhe Adivijen e Dhuratën. Ai i rriti e edukoi me kujdes ata me norma morale e njerëzore, me shkollë e edukatë e veçanërisht me qytetari e atdhedashuri dhe sot janë të gjithë familjarë, prindër e gjyshër dhe japin shembullin pozitiv, më të mirin të mundshëm për brezat e ardhshëm kudo ku janë.

Koha bëri punën e saj dhe pas ndryshimeve që ndodhën në dhjetvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar, pasardhësit e tij u shpërndanë nëpër Europë e Amerikë dhe ndërtuan jetën atje ku punojnë e jetojnë. E jetoi me trishtim lagimin e tyre nga vendi.

Parashikoi gjithçka në mënyrë të saktë e disi profetike, organizoi vetë fundin e jetës së tij deri te vendi i pushimit të përjetshëm në një kodër të bukur mbi fshatin Balldre i ri, prej ku shihen disa rrethe. Fëmijët e tij erdhën të gjithë sa ai ishte gjallë dhe u takuan me të. U nda nga jeta më 17 Tetor 2024. Miq e shokë nga të katër anët e vendit, sidomos nga Dibra, Lezha e Shkodra i bënë nderimet e fundit për atë çka ishte e për atë ç'la pas, morën pjesë në përcjelljen e tij. La pas një familje shembullore dhe modelin e tij të mirë, shembullin e njeriut fisnik e human që e deshi vendin, familjen dhe njerëzit e bëri gjithçka për të mirën e tyre.

Kujtimi i njeriut të mirë Sefer Koçi do të jetojë në shekuj dhe do të frymëzojë pasardhësit, shokët e miqtë dhe të gjithë ata që e njohën e punuan me të.

U prehsh në parajsë vëllai dhe mikun ynë i pa harruar.

Tahir Kadareja, njeriu dhe ushtaraku me përmasat e një personaliteti

(Vijon nga faqja 4)

nuk shiheshin me sy të mirë.

Këtë shenjë xhelozie e urrejtjeje, si dhe thelbin se nga buronte ajo çka vërehej në këto instanca, e zbulon edhe shkrimtari Ismail Kadare, në një nga botimet e tij (1992, në Francë, ku ndër të tjera shkruan se: "Gjeneral Tahir Kadareja, ka qenë gjatë viteve të para të luftës, më i njohur se Enver Hoxha dhe ndoshta një nga arsyet e mllëfit të paqartë të këtij të fundit ndaj tij, ka qenë thjesht ndjenja e zilisë, për njëfarë legjende që ende vazhdonte për të, midis partizanëve të vjetër".

Këtu sigurisht kishte të vërteta të mbuluara me mister, që u bënë më të dukshme dhe shpërthyen hapur në Konferencën e Tiranës (1956), tashmë të njohur për veprimtarinë e ashtuquajtur shkatërruese të saj. Aty ai u godit ashpër, krahas disa ushtarakëve të lartë, për

mendimet që shpalli haptas ndaj udhëheqjes së lartë të partisë e të shtetit të asaj kohe.

Ato ishin akuza, prandaj pas kësaj nisi menjëherë kalvari i vuajtjeve për të dhe për gjithë familjen e Kadareve. Së pari, erdhën transferimet, më pas izolimi dhe lirimi nga ushtria dhe, natyrisht përjashtimi nga radhët e partisë. Kalojnë me radhë internimi në Kuçovë e pastaj, si një asket të shkretë, e mbyllin në Zvërnec, ku edhe e burgosin. Kaq i mbyllur, gati hermetik, dhe i frikshëm jo vetëm nga shokët e miqtë, por edhe nga njerëzit e afërt, sa këta e kishin të pamundur ta takonin.

Nga koha e adoleshencës, kujtoj një episod, kur isha nxënës në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe nëna ime donte t'i bënte një vizitë kortezie, një gruajë që ishte e afërt e tij dhe që lëngonte nga një sëmundje e rëndë. Kaq e fshehtë dhe e maskuar u bë ajo vizitë, sa që nëna nuk guxoi t'i thoshte as babait dhe as dajës tim.

Në vitin 1962, ende pa mbushur të pesëdhjetat, më në fund zemra e ish-komandantit trim, e një prej drejtuesve më të njohur të Luftës Antifashiste dhe të formacioneve më të mëdha të UNÇSh-së, e gjeneralit dhe ushtarakut nga më të aftët dhe me shpirt krijues, e artiljerit të shquar e të talentuar, pushoi së rrahuri. Askush nga shokët dhe miqtë, por edhe të afërmit, nuk mundën ta përcillnin në banesën e fundit!

E si mund të bëhej një gjë e tillë, kur çdokush dhe çdo veprim ishin nën kontroll! Megjithatë, me gjithë murin e izolimit, ata ruanin imazhin e komandantit e të luftëtarit, të gjeneralit, të shokut të mirë e të eprorit të dashur, korrekt dhe të ndershëm, të atdhetarit demokrat deri në përkushtim. Për ta, Tahir Kadareja, kishte qenë dhe mbetej njeriu dhe ushtaraku me përmasat e një personaliteti, pjesë e historisë ushtarake shqiptare.

Memorie.al

PORTRET

VETERAN I ARSIMIT HAZIR SELISHTA, STUDIUES I KULTURËS POPULLORE

NGA MEVLUD BUCI

Sa më shumë kalojnë vitet, aq më fort të vjen detyrimi shpirtëror për të pasqyruar provat e përkushtimit në udhën e dijes. Midis shumë veteranëve të arsimit në Dibër, shëmbellen edhe figura e Hazir Selishtës. Këtë njeri e kam njohur nga afër dhe kam ndjerë e respektuar përvojën e tij si mësimdhënës e drejtues.

Hazir Selishta u lind në vitin 1948 në Brezhdan, fshat me tradita arsimore. Babai, Hakiu, e ëma, Lumja, bijë e fisit të nderuar Nela të Brezhdanit, rritën dhe edukuan: Hazirin, Selamin, Njazin, Dëshirën, Sabrijën dhe Elhamen.

Mësimet në shkollën e Brezhdani, dhe më pas përfundimin e Pedagogjikes në Peshkopë, Haziri i mbaron me rezultate të shkëlqyera, po kështu, me këto rezultate përfundon e dhe Institutin e Lartë Pedagogjik - Shkodër, dega Gjuhë-Letërsi.

Filimisht ai e nis punën në Ciklin e Ulët në Brezhdan, ku zbatoi metodat e mësimdhënies dhe u dallua për lidhje me komunitetin. Kjo punë rrezatoi edhe në shkollën e Sohodollit, ku dha mësim për 15 vjet.

Si njeri i veprimtarieve arsimore-kulturore, ai mori nderim nga komuniteti



dhe nxënësit e tij. Këtë e thonë mjaft njerëz nga Kastrioti, Sohodolli, Brezhdani e më gjerë. Puna në vite të drejtim-it, lidhja e ngushtë me nxënësit dhe me komunitetin, lanë gjurmë në jetën e tij arsimore.

Krahas punës e taktit në drejtim, Haziri iu përkushtua edhe mbledhjes së frazeologjisë dhe mençurisë popullore.

Krahas punës në Sohodolli, Haziri shërbeu për 11 vjet si mësues letërsie

në shkollën e mesme të Kastriotit.

Puna si kryetar i komisionit të gjuhës dhe letërsisë për rrethin e Dibërës, mbledhja e fjalëve të rralla, do të reflektonte pasionin e tij, zotësinë, zellin në fushë të pedagogjisë.

Në vitin 1994, Haziri u emërua zv-drejtor në shkollën e Brezhdanit, që ishte shkollë 9-vjeçare dhe nga viti 2000-2012, ishte drejtor i saj, vit ky i fundit, kur del në pension.

Si cilësi etiko-morale, krahas përgatitjes profesionale të lartë, Haziri kishte komunikimin e çiltër me nxënësit, ishte i papërtuar, por edhe i rreptë në zbatimin e rregullores dhe të ligjshmërisë arsimore.

Duke qenë njeri i dashur, mirëkuptues, njeri që prin me shembullin personal, ai i gëzoi këto cilësi dhe i rriti e u dha kuptim edhe për të tjerët. Për përdorimin e metodave të reja duke studiuar literaturën më të re arsimore, dhe për rezultatet e arritura, ai u dekorua nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Urdhrin "Naim Frashëri"-Klasi i Parë.

Puna në arsim i dha atij edhe shtytjen tjetër krijuese kur ai u takua dhe bisedoi me 65 pleq nga Kastrioti, Sohodolli, Brezhdani e në zona të tjera, duke mbledhur nektarin e cmuar të urtësisë popullore, të shprehjeve e

fjalëve me peshë, që dalin nga kjo urtësi në shekuj dhe që kanë vlera të padiskutueshme.

Njohës i mirë dhe i artit, i letërsisë dhe kulturës, ky arsimtar dhe drejtues i përkushtuar e zgjeroi sferën e intereseve të veta kulturologjike, duke u bërë një hulumtues i zoti. Shpesh ai citonte e citon vargje dhe më për zemër kishte vargjet e Dritëro Agollit, ku i pëlqente strofa: "I bardhë si bora të jesh/ I ndritur e i larë me flurui/Prapë se prapë do të shajnë/ Se pa sharë s'ka mbetur njeri."

Bashkë me bashkëshortin e tij Suzana, bijë e fisit Islami të Sohodollit, edukuan tre fëmijë si yje: Enkeleda (edukatore), Mefati (mjek -kardiolog), dhe Ajdi (specializuar për shkenca kompjuterike).

Haziri ka qenë bashkëpunëtor shkencor i jashtëm i Institutit të Gjuhë-Letërsisë të Akademisë së Shkencave, ka botuar në revistat pedagogjike shkrime të fushës profesionale, te "Gjuha jonë", në gazetën lokale të Dibërës "Ushtima e maleve".

Ka pak muaj që jeton në Tiranë.

Në bisedë me të ai të thotë: "Krahas profesionit, që është detyrë, gjithnjë njeriu, intelektual, duhet të vrasë mendjen sipas prirjeve dhe aftësive të tij, të bëjë diçka më tepër, që të jetë më i dobishëm për veten dhe për të tjerët".

81 vjet më parë - Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

(Vijon nga faqja 6)

cioniste. Humbjet e këtyre forcave, sidomos të Brigadës së 2-të ishin shumë të mëdha. Forcat e Brigadës së 3-të kaluan në zonën e Matit e Lurës dhe më vonë në atë të Pezës ndërsa forcat e Brigadës së 2-të kaluan në zonën e Tiranës e Krujës. Veprimet luftarake të forcave partizane në operacionin e Shëngjergj-Martanesh-Çermnikës, si rrjedhojë i një vlerësimi jo të drejtë të situatës nga Shtabi i Përgjithshëm me Enver Hoxhën në krye u shoqëruan nga një humbje e madhe e forcave partizane dhe nga një imazh i keq. Pas këtyre goditjeve të vogla në të gjitha qarqet e vendit, më 7 janar 1944 filloi Operacioni Armik i Dimrit, njëherësh në zonën e Korçës, Elbasanit e Beratit. Armiku synonte ti shtynte forcat partizane sa më në Jug, t'i rrethonte dhe ti asgjësonte ato. Brigada e 4-të luftoi me trimëri e heroizëm në vijën e frontit....- Voskopojë-Gjergjevicë dhe nuk i lejoi forcat gjermane të përparonin. Ndërsa në zonën e Beratit, në drejtim të Tomoricës dhe nga Elbasani armiku mundi të përparojë dhe arriti në Mazrekë të Oparit. Kjo dalje vuri në rrezik forcat e Brigadës së 4-të e cila me një manovër të shpejtë çau rrethimin duke kaluar në Qafën e Beçit (Mali Ostrovicë) dhe kaloi në Potom (Skrapar). Gjermanët pushtuan Tomoricën, Sulovën, Nahijën e Beratit, Gorën dhe Oparin duke kryer një terror të paparë nëpër fshatra me synimin për të shkëputur nga lufta masat e popullit. Tentativa e armikut ishte që të dilte nga Çorovoda në Tendën e Qypit për në Përmet. Forcat partizane të Qarkut të Beratit dhe sidomos forcat e Brigadës së I-rë luftuan heroikisht në Tendën e Qypit duke arritur që ti ndalojnë dhe ti detyrojnë të tërhiqen gjermanët. Një ndihmë të madhe dhanë dhe

forcat partizane të Brigadës së 6-të që sapo ishte formuar në Përmet.

Gjermanët kudo që shkuan dogjën, vranë dhe plaçkitën por nuk ia arritën qëllimit për të shpartalluar Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Armiku po të njëjtin operacion bëri edhe në Qarkun e Vlorës kundër Brigadës së 5-të e cila u rrezikua seriozisht, por manovrimi i saj dhe ndihma e popullsisë bëri që ajo, jo vetëm të çante rrethimin, por ta godiste armikun në befasi.

MËSYMJA E PËRGJITHSHME E UNÇL

Kur nazistët gjermanë dhe kolaboracionistët po i jepnin fund operacionit në pamundësi të asgjësonin Ushtrinë Nacionalçlirimtare shqiptare, forcat e UNÇL u hodhën në mësymje: Brigada e 5-të në Qarkun e Vlorës, Brigada e 4-të në Qarkun e Korçës, Brigada I Sulmuese në Qarkun e Beratit, Brigada e 6-të në zonën e Lunxhërisë e Zagorisë. Kështu ata i dhanë goditje të fortë armikut dhe filluan të çlironin të gjitha zonat që kishte pushtuar ai gjatë operacionit.

Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar. Në luftime të ashpra në kushte të pabarabarta, në një dimër jashtëzakonisht të vështirë humbjet e partizanëve ishin mbi 1000 veta por radhët e UNÇL shqiptare u shtuan dhe u forcuan, ndërkohë u rrit besimi i popullit në fitoren mbi pushtuesin. Gjatë Operacionit Armik të Dimrit u çimentua dashuria dhe besimi i patundur i luftëtarëve të lirisë për detyrën e lartë të çlirimit të Atdheut..., u rrit ndërgjegjja dhe përkushtimi i partizanëve për një organizim të përsosur, manovër të shkëlqyer e disiplinë të lartë të UNÇL. U rrit në shkallën më të lartë besimi i popullit tek Ushtria Nacionalçlirimtare si e vetmja forcë që do ta çlironte vendin nga pushtuesit gjermanë.



SUPLEMENTI FJALA

Mirë... po prapa diellit

Tregim nga Sulejman MATO

Ekeni vënë dhe ju re? Njerëzit sa vjen e bëhen më të ftohtë në marrëdhëniet midis tyre.

I shoh në rrugë dhe, ndërkohë që kërkoj të shkëmbej me ta një buzëqeshje, më kthejnë një gjysmëbuzëqeshje kortezie dhe askush s'ndalon nga vrapimi i pakuptimtë drejt fundit.

"Mjaft me hallat tona, - sikur thonë, - ç'na duhen hallat e të tjerëve". Por njeriu për të cilin dëshiroj të flas nuk është nga këta lloj njerëzish karakter prishur, ndonëse gruaja i ka vdekur prej kohësh e fëmijët e kanë braktisur, nuk i janë tharë ndjenjat. Mbahet heroikisht, i lidhur fort me të djeshmen krenare. Sytë e tij të kaltër, nën vetullat që nuk mbahen mend qyshkur i janë thinjur, së bashku me flokët të cilat të kujtojnë një rini bionde, reza-tojnë përherë dashuri, shpirti i tij i paplakur reza-ton mirësi dhe një humanizëm primitiv. I shkurtër dhe dinamik, plakushi për të cilin kam dëshirë t'ju tregoj diçka, ka një ecje sikur shtyn erën me gjoks, sikur në vrapim e sipër në turravrapin e fundmë kërkon të presë shiritin e jetës.

Emrin nuk ia di, s'ia kam mësuar. Sa herë rastisim të takohemi ai do të më bëjë gjithmonë të njëjtat pyetje dhe unë do të kujtohem t'i kthej të njëjtat përgjigje:

-Çuni mirë?

-Mirë.

-Po vajza, mirë?

-Mirë.

Po ju të gjithë mirë, me vëllezër me motra, mirë?

Mirë. Mirë.

Pastaj ia nis unë nga e para:

-Po ju fëmijët, mirë?

-Mirë.

-Djemtë, vajzat, mirë?

-Mirë..

-Djali i vogël në Londër është rregulluar me letra?

-Jo. Akoma, - thotë ai sikur të ishte faji i tij.

Fillimisht, kur takoheshim, vija re që "mir-a" e tij ishte tepër entuziaste, por sa më tepër kalon koha aq më tepër zbrzet ca shkallë nga ajo "mir-a" e tij e parë, entuziaste.

-Po vajza në Gjermani, mirë?

-Mirë - thotë ai me një gëzim të shtirur, ndërkohë që vajza e tij ka 16 vjet që i ka lënë pendët, së bashku me të shoqin. Ikën në kohën e ambasadave, janë rregulluar, por plakushin e gjorë e kanë harruar fare.

Epo. 16 vjet në një vend të huaj nuk janë pak. Kanë lindur dhe rritur fëmijët të cilët nuk dinë asnjë fjalë shqip.

-Po djali t'u kthye nga Zvicra? - pyet ai. Këtu gabon, në këtë pikë babushi me vetulla të thinjura ka



gabuar disa herë, pasi djali im ka 16 vjet që është kthyer nga Zvicra, dhe ne, gjatë kësaj kohe jemi takuar qindra herë. Herën e fundit ai më tregoi për djalin e madh që kishte marrë letrat në Kanada.

-Eh! More bir, - pëshpërit ai me një ndjenjë sëkëll-die, - mirë, mirë i kemi.

-Do të ishte më mirë që njërin djalë ta kishte këtu, sidomos atë të voglin, - i them unë për të provuar si do të reagojë.

-Joo! Ç'ne këtu? - i shkëlqejnë sytë me tmerr. - Ptul! Larg qoftë. Të marr në qafë fëmijët tani në pleqëri. Të shohin jetën e tyre. Të kenë jetën e tyre, pa unë e hëngra çairin

Sado optimiste të dukeshin, fjalët e tij rridhnin si lot nga zemra e plakur. Çairi i tij në mos ishte ngrënë plotësisht ishte andej nga fundi.

Ndërkohë që më zgjati dorën, konstatova se sytë e kaltër nuk mund të shprehin dot trishtime të mëdha.

Një ditë tjetër u takuam rastësisht në trotuar.

-Hë? - më tha ai sa më pa. - Djalin këtu?

-Këtu.

- Po vajzën këtu?

-Këtu. Këtu.

- Të qenka kthyer nga Zvicra?

- Po, - i thashë unë, pa i dhënë rëndësi sklerozës së tij.

-Po ti, mirë, djemtë, nipçet, vajzën, mirë?

-Mirë, mirë. - M'u duk sikur vetëm për një çast

ëndërroi të lozte rolin e heroit, domethënë të një babushi të lumtur, pasi çdo gjë tjetër, duke filluar nga sytë, humbja e kujtesës dhe ditët e kaluara plotësisht në vetmi, tregonin për diçka tjetër, shumë të rëndë.

-Të merr malli, sigurisht? - i thashë.

-Ç'pyet? Po ç'të bëj. Ç'të bëj!

-Të marrin në telefon?

-Jo ç'ne. Ku kam lekë unë për t'i prishur me telefona.

Nuk më kishte dëgjuar mirë ose do t'i kishte nisur shurdhimi i veshëve.

Duke e vërejtur me kujdes më shkoi mendja përsëri te sytë kaltëroshë dhe në atë çast u binda përfundimisht se vetëm sytë e zinj janë të aftë për të shprehur një dhembje të madhe, të këtij lloji. Sytë e kaltër janë të mallkuar të mos e shprehin dot botën e madhe të dhembjes.

Më shtrëngoi putrën e dorës fort dhe iku me ngut si të kishte një hall e s'dinte kujt t'ia tregonte. S' dinte kujt t'i zbrazej dhe ja, më gjente mua si një njeri i ngeshëm, mbase më ngatërron me ndonjë njeri të njohur? Sigurisht më ngatërron. Apo ka marrë vesh që unë shkruaj dhe ka thënë: këtij njeriu do t'i rrëfej gjithçka. Botë e keqe!

Ju thashë, emrin jo vetëm nuk ia dija, por as u përpoqa t'ia mësoja kurrë.

Një ditë tjetër u takuam përpara pasticerisë "Laguna". Ka qenë 30 dhjetor, një ditë para Vitit të Ri, mes rrëmujës së qytetarëve që nxitonin për përgatitjet e funditvitit, vetëm ai kishte një ecje të ngeshme dhe pa drejtim. Ky ka qenë dhe takimi ynë i fundit.

Si gjithmonë ishte ai i pari që niste me pyetje standarde:

Po hë? Ç'kemi fëmijët mirë?

-Mirë.

-Vajza mirë?

-Mirë.

-Djali është kthyer nga Zvicra?

-Ka kohë. - Nxitova ta ndihmoj për të mos i lënë shteg arteriosklerozës së tij. -Po ti si i ke andej?

-Mirë. - tha ai. - Ishte një "mirë" e përvuajtur, e zgjatur dhe e sëkëlldisur, një "mirë" si e vrarë me shtizat e heshtjes së gjatë dhe si e masakruar me pickimet e një indiference të pakufishme. Pastaj diçka shtoi si nëpër dhëmbë: "Mirë, mirë, por prapa diellit".

Desha t'i thosha diçka ngushëlluese, më tepër për t'i dhënë kurajë asaj fytyrë të plakur dhe disi të përhumur. I kishte humbur krejt shpresat, ndonëse sytë e kaltër i shkëlqenin si xham. Atë mëngjes kishte vendosur dhe ai të gjallonte nëpër rrugë trimërisht, duke mos dashur t'i dorëzohet vdekjes para kohe e cila kishte disa ditë që kishte trokitur në apartamentin e tij të vetmuar.

Ditët e tjera nuk e pashë më. Më ka mbetur në mend fytyra e tij. Nuk ia mësova emrin. As ku banohte....

“SHTËPIA E VERDHË”, PROTESTA E MEREMES NDAJ CARLA del PONTE

...dhe një tufë ferrash në varrin e Dick Marty, nga Destani, i Zoti i Shtëpisë...

(Vijon nga faqja 8)

mos në rrëfimin e gjendjes së Naimit, që ndonëse ka barrën e drejtimit të familjes (të shtëpisë së verdhë) i kanë vënë një nofkë që nuk është e vërtetë. Por nofkëvënësitet nuk e kanë me këtë njeri të thjeshtë që është kujdesur gjithë jetën të jetë i ndershëm. E kanë me luftën ku ai nuk ka marrë pjesë. "E kanë me UÇK-në. E kanë me Kosovën.

E kanë me Shqipërinë. Duhet të njollosohen për të bërë të pavlefshme luftën". (Fq. 167). Këtu, autori të befason me bukurinë e fjalës kur shkruan se Naimi, kurrësesi nuk duhet t'i qases vetëvarjes. Sepse, nëqoftëse ai var veten, s'ka kush të dëshmojë të kundërtën. Askënd nga fshati nuk mund ta besojnë sa atë që ka mbi shpinë të pavërtetën (e shtëpisë së verdhë). Ai duhet të shkund nga supet këtë zift ngjites, bashkë me mizat që kanë ngecur aty. Duhet të dëshmojë të vërtetën. Duhet të jetojë për t'ia hequr

këtë barrë të rëndë nga supet Naimit, Meremes, njerëzve të tij të afërt. Mjafton për këtë perifrazimi i autorit në fundin e faqes 168:

"Këshilli i Europës e ka mbyllur këtë çështje pa gjetur fakte, - thotë Albani.

-Dick Marty ka vdekur, ndërhyt Viktori.

-Atëhere mbillni një tufë ferrash në varrin e tij nga ana ime, - thotë Destani dhe përsërit si një porosi për t'u çuar në vend pa tjetër: -Mbillni ca ferral!"

Bashkim Hoxha befason kështu lexuesin me romanin "Shtëpia e verdhë". Pasi ka befason me "Kronikat e mjegullës", "Një ditë si Skënderbeu", "Heronjtë e viagrës", "Gruaja e shiut", "Duartrokotësit", "Një shaka e vogël me vdekjen, "Asnjëherë të martën", "Dimri i librave", "Vito" e "Dëshmitari i shkretëtirës, me dramën e komeditë e inskenuara e të ndjekura nga mijëra shikues, Bashkim Hoxha vjen sërish me librin e fuindit me titullin intrigues "Post Scriptum"-rrëfim..

TAKIMI

Festat e fund vitit bënë bashkë shkrimtarët dhe veteranët

Nga Nuri Bufi

Manifestimi i festave të fund vitit nga Shtëpia e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Durrësit, në prani të përfaqësuesve të OBVLP të këtij qyteti, na dëshmon për të vënë në pah domosdoshmërinë dhe përjasjen e tyre sa fisnike dhe qytetare.

Së pari, janë shkrimtarët dhe artistët ata që i dedikohen jo vetëm kësaj organizate veteranësh, si rrjedhë e epopesë së lavdishme e historisë së popullit tonë. Dhe më tej janë shkrimtarët dhe artistët që kanë për obligim shpirtëror, të ngrenë deri në pedestal figurat e heronjve të rënë heroikisht si në kohë lufte e në paqe, me këngë dhe me historinë e tyre frymëzuese ndaj masave të gjëra popullore.

Kjo frymë filozofike mes nesh është një farë e mbjellë dhe e mirëkultivuar ndër shekuj e kthyer në shtratin jetik, për të cilën bota përtej nesh formon dhe ngre simpoziume të tëra shkencore me ndarësi, interesa e kostoje dhe nuk ia arrin nocioneve tona morale.

Ky binom vlerash shquhet në trojet shqiptare që në mesjetë, të cilët kanë urreyer shtypjen sa që për lirinë kanë flijuar edhe fenë. Për këtë periudhë mesjetare dhe iluministe shkruajnë për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, emra të mëdhej nga të gjitha shtetet e Europës edhe më gjerë.

Ky shkrim përkon dhe referohet në vigjilje të 17 janarit të ditës së vdekjes së heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Biografia e parë e Skënderbeut është shkruar nga Martin Segoni, më vonë nga Marin Barleti, prifti shkodoran që botoi në latinisht për herë të parë në Romë, gjatë viteve 1508-1510, një biografi zyrtare për Skënderbeun dhe pse përdori si referencë Martin Segonin. Duke iu referuar obligimit shpirtëror në luftrat shekullore të popullit tonë, janë shkrimtarët ata që historitë i mbajnë të gjalla ndër shekuj në memorjen njerëzore. Mbi heroin tonë kombëtar Skënderbeu ka shkruar mirënjohuri Sabri Godo, Virgjl Kule, nga Aurel Plasari "Skënderbeu- një histori politike." i cili i merr dokumentat nga arkivat e Milanos.

"Historinë e Skënderbeut" shkruar nga Fan Noli i cili e përdor si temë të diplomimit në Universitetin e Bostonit. "Skënderbeu", një histori e rezistencës shqiptare ndaj ekspansionit islamik në Europën e shekullit të XV-të shkruar nga A.K.Brackob. I cili argumenton se sukseset e Skënderbeut shpëtuan Italinë dhe qytetërimin perëndimor duke penguar operacionet ushtarake të Mehmetit të dytë.

Shkrimtari dhe historiani hungarez Julius Pisko shkruan tek monografia "Skënderbeu një studim historik" botuar në Vjenë në vitin 1894, në veprën e tij ai shkruan: Gjergj Kastrioti Skënderbeu, heroi kombëtar shqiptar është pa dyshim një nga



figurat më të spikatura të mesjetës.

Duket e pa besueshme që, një njeri i cili nën komandën e tij me jo më shumë se disa mijra ushtarë të ketë mundur të përballojë njëzet e katër vite me radhë ushtrinë osmane dhe të triumfojë mbi të, ndonëse ajo ishte dhjetë apo njëzet herë më e madhe në numur. E gjithë Europa dridhej nga ecuria e fitoreve të pandalshme të kalifëve otomanë. Ndërkohë që në një vend idilik të veçuar si Shqipëria thërmoheshin të gjitha përpjekjet e kësaj perandorie, nga vendosmëria e hekurt e një personi, i cili ishte në gjendje që në një vështrim t'i kthente ushtarët e tij në heronj.

Talenti strategjik i shkëlqyeshëm i Skënderbeut, gojtari entuziast dhe gjithë magjia që dilte nga personaliteti i tij, e vendosin atë denjësisht në anën e heronjve më të rëndësishëm të të gjitha kohrave, në Europë e më gjerë.

Manifestimin e organizuar nga Shtëpia e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Durrësit, në prani edhe të komitetit të veteranëve e hap kryetari Agim L. Bajrami, i cili pas prezantimit, falenderoi pjesmarrjen dhe përfaqësimin nga komiteti i veteranëve të rrethit Durrës me kryetarin e saj zotin Besim Shahini. Agim L. Bajrami njëkohësisht në cilësinë e një shkrimtari të mirëfillt, bën një rezymë të shkurtër të punës krijuese një vjeçare të gjithë shkrimtarëve dhe poetëve, lidhur me prurjet mjaft të larmishme të bukura, të mirë lançuara dhe gjithë ngjyrëshe për vitin që po lemë pas. Dhe me urimin për suksese të mëtejshme gjatë vitit 2025, ai e përcjell këtë urim të njëzëshëm me trokitjet e gotave me verën tradicionale si çdo fund

• Me këtë manifestim të përbashkët të shkrimtarëve dhe me pjesmarrjen e organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve Durrës, përmbushet më së miri tradita shekullore e popullit tonë se pushka dhe pena përbëjnë kollonën vertebrale të ekzitencës së kombit shqiptar

vit, të gjithë të bashkuar.

Mes këtij entuziasmi që shoqërohej në vazhdim nga tingujt muzikor të orkestrës si dhe në prani të zërit të preferuar nga këngëtarët Ylli Çifti, Naim Kërçuku, Julieta Strefi dhe këngëtari Dhimitër Stefa.

Në një moment pauze, shkrimtari i ri Pol Milo i ngarkuar nga Komisioni me rolin e moderatorit i japin fjalën kryetarit të veteranëve zotit Besim Shahini, fjala e tij nisi me një slogan profetik. Ai citoi: Se në botë historitë i bëjnë popujt, por gjithmonë nuk nën çmohet roli i individit të shquar, mbasi nga aftësitë strategjike të dejtuesit bëhen vendimtare dhe fitoret.

Si koherente të fjalës tij zoti Besim Shahini vlerësoi punën demonstruese, rolin inkandeshent që bëjnë shkrimtarët dhe artistët, veçanarisht komplementoj punën organizuese të Shtëpisë së Shkrimtarëve dhe Artistëve të kryesuar me zotin Agim L. Bajramin, i cili me përkushtimin e tij prevalues në fushën e artit dhe të krijimtarisë letrare nderon jo vetëm qytetarinë durrsake, por gjithë atë kombëtare, përfundoi ai.

Nga fjala e kryetarit të komitetit të veteranëve zotit Besim Shahini merr shkas protagonizmi i përshtjellimit të shkurtër të historigrafisë së lashtë të popullit tonë si më sipër.

Larminë e kësaj atmosfere të bukur mes arenës muzikore, e shtuan dhe dhënja e një sërë stimuljesh dekoratash, si "Mirmnjohje e vitit", për novatorizëm dhe publicistikë në krijimtarinë letraro poetike. Në dorëzimin e distiktivëve moral, kryetari zoti Agim L. Bajrami organizoi dhe shkrimtarë të tjerë të motivuar për nga mosha dhe kontribute të veçanta, midis tyre vlen të përmendim shkrimtarin njëkohësisht si poet, zotin Skënder Milaqi. I cili është vlerësuar me çmim të parë nga Shtëpia e Shkrimtarëve dhe Artistëve, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në krijimtarinë e tij shumë ngjyrëshe romantike dhe poetike si romanin "Klara", libri "Magjia e lotit" dhe cikli me poezi "Më pëlqen të shkruaj".

Midsi shkrimtarëve që u nderuan me stimuj, një vëmendje të veçantë mori nga të gjithë të pranishmit vlerësimi me titull "Mirnjohja e vitit" për poeten Adivije Hoxha. Kjo poete me aftësi të kufizuar në fjalën e saj falenderuese mbi vlerësimin nga kryesia e shkrimtarëve shtoi: se ndihem si luftëtare aktive dhe e barabartë mes jush, duartrokitjet e tejjgjatura të sallës mbushën plot zjarr dhe e bënë më trime poeten Adivije Hoxha.

Të mirpritura qenë edhe vlerësimet për poetët dhe shkrimtarët e rinj, si Sara Shaqiri, Xherjana Istrefi, Pol Milo, Violeta Beshiri etj.

Në fund një vlerësim i posaçëm iu akordua Restorantit "Medi terrania" Durrës.

Me këtë manifestim të përbashkët të shkrimtarëve dhe me pjesmarrjen e organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve Durrës, përmbushet më së miri tradita shekullore e popullit tonë se pushka dhe pena përbëjnë kollonën vertebrale të ekzitencës së kombit shqiptar.



FOTOREPORTAZH

Salla e Konferencave Ndërkombëtare të FPU merr emrin e kreut shqiptar më të suksesshëm

ALFRED MOISIU – NJË JETË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE PAQES

(Vijon nga faqja 3)

TË RRISIM KUJDESIN PËR NDALIMIN E SHPËRBËRJES SË FAMILJES SHQIPTARE

Nëntëdhjetëpesë vite punë dhe përpjekje për të bërë më të mirën për shoqërinë, familjen, vendin nuk janë pak. Pasi shprehu kënaqësi dhe nder të për këtë akademi jubilarë që organizoi në 95 vjetorin e lindjes së tij Federata Shqiptare e Paqes Universale, e mbështetur edhe nga qendra, (gjë për të cilën falenderoi përzemërsisht drejtuesit e saj dhe në mënyrë të veçantë përfaqësuesit që ndodheshin në këtë sallë, e në veçanti Presidentin Vujanoviç, zotin Vilson Ahmeti dhe Dr. Song, Sekretarin e Përgjithshëm të FPU Gani Rroshi), Presidenti Moisiu solli disa kujtime të paharrueshme gjatë punës në interes të kësaj Federate.

“Jam njohur për herë të parë me Federatën dhe aktivitetin e saj në shtator 2004 në Neë York, kur, unë isha në mbledhjen e sesionit vjetor të saj si kryetar i delegacionit shqiptar. Atje erdhën më takuan Ish Presidenti Meidani, zoti Gaqo Apostoli dhe Sekretari i Përgjithshëm i UPF Dr. Tomas Uollsh. Ata më informuan për herë të parë mbi rolin dhe punën e Federatës dhe në të njëjtën kohë më vunë në dijeni mbi dëshirën e reverendit Mun për të bërë një vizitë në rajon, të cilën donte ta fillonte nga Shqipëria. Sigurisht e mirëprita dëshirën e tij, ndërsa në 2005 e prita në rezidencën verore presidenciale. Ajo që më ra në sy dhe më bëri të ndjek mësimet e Reverendit Mun është kujdesi dhe qëllimi kryesor i tij për forcimin e familjes, mbështetja e njerëzve në fatkeqësi dhe ruajtja e paqes. Këto janë tre shtylla të rëndësishme për ekzistencën dhe ruajtjen e një shoqërie normale.”, -tha Presidenti Moisiu. Më pas ai apeloi që të mos harrojmë që bota krahas zhvillimit të saj të vullshëm të teknologjisë dhe lindjes së problematikave të ndryshme shoqëruese të kësaj ecurie, ka bërë dhe vazhdon të bëjë disa ndryshime shumë domethënëse në marrëdhëniet shoqërore që po çenojnë rëndë tre shtyllat kryesore historike të ekzistencës dhe formësimit të mëtejshëm të shoqërisë bashkëkohore. Pikërisht kjo, sipas tij na vë të gjithëve në mendime dhe na detyron të rrisim kujdesin për ndalimin e shpërbërjes së familjes shqiptare si dhe



ruajtjes së paqes në rajonin tonë të brishtë. Me këtë rast duhet të them se koordinimi i veprimtarisë midis UPF dhe Klubit të Podgoricës ka qenë dhe vazhdon të mbetet si gur temeli të rëndësishëm në veprimtarinë tonë. Falënderit President Vujanoviç, për kontributin tuaj personal në këtë nismë tepër të rëndësishme për rajonin.

Jemi dëshmitarë të disa zhvillimeve tragjike në skenën botërore, veçanërisht në Europë dhe në Lindjen e Mesme, të cilat po vënë në rrezik serioz paqen botërore. Po ti shtojmë këtyre edhe rreziqet e mundshme në rajon e veçanërisht në marrëdhëniet midis Kosovës dhe

Serbisë, del e domosdoshme intensifikimi i përpjekjeve tona për të ndikuar sadopak në zbutjen e marrëdhënieve dhe shmangien e rreziqeve për acarimin e mëtejshëm të situatave, gjë të cilën ne e kemi pasur në qendër të vëmendjes”-tha Moisiu. Për ish kreun më të suksesshëm të shtetit shqiptar të këtij çerek shekulli, problemet e rajonit, të Europës me zigzaket e tyre të zhvillimit, na detyrojnë të jemi të kujdesshëm dhe të vëmendshëm për të kontribuar në kohë për shmangien e tyre. Ai shpesh binden se Federata e Paqes Universale do vazhdojë të kontribuojë. “Detyra që më ngarkoi reverentja Mun në Konferencën e Tiranës në 2019 si Kryetar i Këshillit të lartë të Paqes për Ballkanin ishte për mua një nder por edhe një detyrë tepër e rëndësishme, që i ka shërbyer shumë qëllimit të ruajtjes dhe forcimit të paqes. Ne sëbashku me Klubin e Podgoricës kemi zhvilluar një sërë aktivitete të përbashkëta të suksesshme në kuadrin e arritjes së këtyre qëllimeve shumë të rëndësishme.

Unë edhe një herë ju falenderoj për respektin që treguat ndaj meje, duke u angazhuar sa ta kem të mundshme fizikisht, do jem në radhët e Federatës për të ndihmuar dhe kontribuar në realizimin e detyrave për të cilat fola më sipër”, e mbylli fjalën e tij përshëndetëse Presidenti Moisiu. Pjesa e fundit e veprimtarisë iu kushtua vlerësimit të pesë personalitetëve të nderuara me titullin “Ambasador për Paqe”, të përzgjedhura me shumë kujdes nga drejtuesit e Federatës. Personalitete që u nderuan ishin Dr. Mehmet Prishtina, Prof. Dr. Greta Angjeli, Prof. Dr. Klodeta Dibra, Z. Haki Çako dhe znj. Maria Solis.



të zvenitjes të ndjenjës së solidaritetit dhe ndihmës për njerëzit në nevojë. Gjithashtu rëndësi të madhe në rajonin tonë të Ballkanit ka pasur edhe ka akoma më shumë rëndësi aktualisht ruajtja e paqes dhe mirëkuptimit midis popujve të rajonit.

“Nisur nga zhvillimet dhe situata jo e mirë në Ballkan, duke qenë në lidhje të ngushtë me drejtuesit e disa vendeve të rajonit në suazën e Klubit të Podgoricës, bashkëpunimi me të cilin ka qenë shumë efektiv për rritjen e mundësive paqeruajtëse në rajon. Për stabilizimin e kontakteve dhe lidhjeve të afërta të ish drejtuesve të shteteve të rajonit. Dëshiroj të theksoj këtu se njeriu që hodhi idenë shunë të vlefshme të krijimit të kësaj strukture ishte i nderuari President Vujanoviç, për të cilin unë prej kohësh kam një respekt të veçantë si luftëtar efektiv i

